

Shqipëria Natyrale (botuar ne nentor 2006)

Shqipëria Natyrale
Natural Albania
Reçenzentë

Frrok Cupi
Aleksandër Cipa
Arsim Sinani

Shtëpia Botuese
Erik

2006

Edhe një libër që trazon

Ç'është kjo "Shqipëri natyrale"?

Frrok Çupi

Ky libër që ke në dorë, i dashur lexues, do të të trazojë mendjen, me siguri. Mund të jesh një lexues që ke humbur lidhjet me librat e rilindasve shqiptarë; mund të jesh një lexues që ke lexuar qindra artikuj mbi Shqipërinë dhe fqinjët, por nuk ke kuptuar ndonjë gjë të madhe, por ta dish se ky autor shkruan shumë qartë; mund të jeshë edhe një lexues që mendon se kombi yt nuk ka gabuar kurrë, por vetëm e kanë dhunuar. Prandaj po them se me këtë libër do të mund trazohesh përsëri, i dashur lexues. Sepse autori i tij, studiuesi Koço Danaj, ka prekur "ashpërsisht" disa pika që lëndojnë nervin kombëtar. Koço Danaj ka ardhur si një rilindas, tashmë që rilindasve u janë thyer edhe varret në kodrën e Parkut të Madh. Autori i librit është aq nervoz me Europën e mureve që izolojnë shqiptarët, ashtu sikurse është krejt i rrafshët me patriotët e vet shqiptarë që i duket sikur nuk kanë asnjë mëkat në qytetërimin botëror. Koço iu kërkon kancelarive politike të botës që menjëherë të vënë në vend padrejtësinë ndaj shqiptarëve të copëtuar në disa shtete; ai kërkon që "ashtu siç u pjesëtua për pesë, të shumëzohet për pesë".

Ky libër është plot me të vërteta të qëmtuara në diturinë e përgjithëshme historike e politike, është libri i një autori që rrëmon gjithnjë librin dhe diturinë. Ky është një fat i mirë për ty i dashur lexues; sepse me siguri ke lexuar libra nacionalizmi me ofshama dhe pa dituri. Koço Danaj i ka bërë shumë kolegë të tij që "ta harrojnë" pikërisht pse Koço ka me vete njohjen e

të vërtetës edhe për ato zona (Prishtinë e Shkup) ku nuk shkon dot këmba e studiuesve që nuk mund ta pinë kafën jashtë Tiranës.

Ato çfarë Koço të ka "fshehur" i dashur lexues, t'i ka fshehur me qëllim, jo pse nuk i njeh. Të ka fshehur të vërtetën se për fatin e tyre shqiptarët kanë edhe përgjegjësinë e tyre, gjë që autori ua ngarkon me "pa mëshirë" vetëm politikanëve shqiptarë. Nuk mund të jetë e vërtetë që vetëm politikanët t'ia kenë fajin përjetësisht një kombi. Koço Danaj, i dashur lexues, të ka "fshehur" të vërtetën se jetojmë në epokën e shteteve, madje edhe të shteteve nacionale; por jo në epokën e kombeve, aq më pak të kombeve pa shtet. Sepse, miku im Koço, shkruan se në vend të dy presidentëve dhe tre zëvendëskyreministrave e 70 zëvendësministrave, duhej të kishim vetëm një palë nga këto "harxhe". Nuk është kështu, i dashur mik; qytetarët marrin pjesë në shtet aty ku shtetërohen, pavarësisht nga feja, raca dhe kombësia.

Kam frikë se autori mendon se "nuk është mirë që jemi të përhapur në pesë shtete, kur unë mendoj se është më mirë kur kombi zgjerohet dhe qytetërohet.

Dhe më në fund, autori i librit ka harruar të tregojë për ku duhet drejtuar "treni" i kombit, përderisa Brukseli e ka me hile. Që në Bruksel ka plot zyrtarë hileqarë e naivë, këtë as e mohon njeri, por ku të shkojmë; jo në Europë? Është koha e rirreshtimit të kombeve, dhe shqiptarët askush nuk po i orienton për ku.

Kronologjia rigoroze e analistit me njohje

Aleksandër Çipa

Analistin Koço Danaj e çmoj gjithmonë për njohjen. E kam fjalën për njohjen e tërësisë sonë etnike, si hapësirë dhe si indshtrirje. Në këtë plan, Danaj mbetet tipik dhe i pakrahasueshëm me ndokënd tjetër.

Qasjet e tij të përcjella për çështjen kombëtare shqiptare, veçohen për pathosin dhe tendencën inversuese. Në veçantinë e vet, Danaj spikat si qytetari sfidues i kufirit të përcaktuar imponueshëm prej forcave madhore të politikëbërjes dhe gjeopolitikvendosjes.

Në këtë adresim, Danaj mbetet analisti që prej kohësh e ka flakur kompleksin e së thënës së asaj që mendon dhe ndjen mendueshëm. Të thënat e tij, në jo pak raste, kanë pasuar me reagime palësh, por më së shumti, me reagime protagonistësh, shumica e të cilëve me staturë dhe mandate institucionale në hapësirën shqiptare dhe në atë të rajonit multietnik. Kjo ka ngjarë, për disa shkaqe, por më lehtësisht të dallueshëm janë shkaku I atdhedashurisë natyrale; shkaku i procesndjekjes si dhe i pasionit profesional që mbart autori i këtij teksti të formësuar në libër. Analisti që ka pronësinë autoriale të këtij libri,

spikat ndër të tjera, për afinitetin e vet me politologjinë dhe analistin e mirëfilltë gjeopolitik njëgjuhësh.

Natyrisht, mes vlerësimit për Njohjen (si proces dhe aftësi vetiake) dhe Deduksioneve të autorit Koço Danaj, personalisht ndaj diferencën time. Mbetem më tepër në simpatinë për njohjen që zoti Danaj ka me individët protagonistë në shumicën e ngjarjeve, për njohjen që ai investon në misionin e vet publicistik dhe analizues si dhe për gërmimin e përhershëm vijues që i bën historisë komplekse të rajonit multikombësh, në funksion të kohëndryshimit. Mirëpo, kur marr në vlerësim tërësinë e fakteve, ngjarjeve, historive dhe refleksionit të përhershëm që autori përcjell për zhvillimet në hapësirën e Shqipërisë natyrale, atëhere më duhet të pranoj si lexues i vëmendshëm, se pasioni i tij e shtyn në gabueshmëri deduktive, por nuk e cënon vlerën e veçantë të njohjeve vetiake. “Shqipëria natyrale” është refleksioni i përmbledhur që nis dhe mbetet i hapur, jo për shkak të historisë, por për arsye të realizmit. Thuhet kjo, në adresë të këtij libri, pasi procesi gjeopolitik në rajonin shumëkombësh ku ze pjesën e patjetërsueshme gjithështrirja jonë kombëtare, ndodhet në çastin kulmor. Ky proces gjeopolitikvendosës për shqiptarët dhe hapësirën e tyre natyrale, gjendet në fazën paraepilogeuse. Është fjala drejtpërdrejtë për atë proces që përmbledh konkretisht zgjimin dhe veprimin kombëtar, akte këto që nuk ka më mundësi të bllokohen apo ndërpriten, as prej vetvetes dhe as prej forcave fqinjëruese. Analisti Danaj, hyn në sërën e atyre interpretëve që nuk e humbasin as në pathos e as në emocion, referencën ndaj bashkësisë primordiale.

Natyrisht, në ndonjë rast, armatura e gjykimit apo vlerësimit të një eventi apo ngjarjeje me multipjesëmarrje aktorësh ballkanikë, të lenë edhe shijen e njëanshmërisë. Ka raste që kjo ngjet vetëm për shkak të përkatësisë etnike të autorit. Danaj në këtë plan, për mendimin tim, evidenton staturën e vet si historiointerpret kombëtar. Si i tillë, përfshihet në vlerësimin që politologu John Plamentz bën për nacionalizëm lindor, për atë nacionalizëm që duket ashiqare në mishmashin etnik të kësaj pjese të Europës të trazuar, ndryshe prej Europës në qendër..

Si pelegrin për atdhedashuri, si ikanak në gjithëterritor dhe me komunikime në krejt hapësirën kombëtare, Koço Danaj, shfaqet dëshmueshëm edhe në këtë libër, si një kronologjist rigoroz nationalist dhe analist me njohje.

Koço Danaj, intelektual i kalon kufijtë ballkanikë pa pasaportë

Arsim Sinani-Prishtine

Shkrimet dhe tezat e analistit dhe intelektualit Koço Danaj i kam lexuar me vëmendje të veçantë dhe gjithnjë më kanë zgjuar interesim të posaçëm. Mendimi i tij padyshim është një mendim shumë i veçantë, i drejtëpërdrejtë dhe komunikon me publikun dhe lexuesin. Nuk e teproj nëse them se Koço Danaj është një misionar i kauzës shqiptare. E gjithë kjo zhurmë për tezat e Koço Danaj për Shqipërinë Natyrale në esencë është jonatyrale, në të vërtetë Danaj ka shtruar një mendim ndryshe nga mendimet e tjera të thëna deri më tani për shqiptarët dhe rreth shqiptarëve.

Por me gjasë mentaliteti provincial ballkanik asesi të lirohet nga kokat e një mendësie joshqiptare e cila është mësuar që shqiptarin ta shoh në çfarëdo pozite përlulëse, vetëm në pozitën e një intelektualit e një njeriu që din ta thotë atë që e mendon nuk është mësuar ta

shoh e akceptojë, dhe kjo mendësi ballkanike nuk pranon mendim tjetër. Kjo mendësi nuk pranon mendimin shqiptar prandaj bëhet gjithë kjo zhurmë mediatike dhe shtrembërohen tezat e Danajt, por pa sukses sepse tezat e Danajt i kalojnë kufijtë Ballkanik.

Padyshim Koço Danaj i kalon kufijtë ballkanikë pa pasaportë, por me një identitet të fuqishëm dhe me një bagazh të një intelektualit që i duhet qytetërimit evropian. Fundja shqiptarët gjithnjë i kanë dhënë qytetërimit evropian vlera të cilat edhe sot e kësaj dite nuk mund të kontestohen. Ky është Koço Danaj i cili komunikimin e tij e ka të drejtë, të çiltër dhe shtron një çështje të rëndësishme dhe interesante.

Në këtë vijë ka qenë kënaqësi e imja ta intervistoj Koço Danaj dhe këtë punë jam munduar ta bëj sa më mirë dhe profesionalisht por asnjëherë nuk më ka shkuar mendja se kjo intervistë do të zgjonte kaq shumë opinion dhe do të hapte debat i cili do ti kalonte kufijtë ballkanikë e do të mbrinte deri në qendrat e ndryshme botërore.

Parahyrje

Kanë mbetur edhe 6 deri në 7 vjet për të festuar 100 vjetorin e krijimit të Shqipërisë aktuale. (Shprehja 6 deri në 7 vjet nuk është përmendur rastësisht. Pavarsia e Shqipërisë u shpall nga shqiptarët në 28 nëntor 1912.

Por njohja e kësaj pavarësie u bë nga Konferenca e Londrës në mesin e vitit 1913. Shpallja e pavarësisë nga shqiptarët nuk presupozonte pavarësinë e Shqipërisë që është sot, por shumë më gjerë. Presupozonte Kosovën dhe Luginën e Preshevës, Pollogun dhe Malësinë e Sharrit, Ulqinin dhe Malësinë në Veri dhe Çamerinë në jug. Pjesmarrja e përfaqësuesve shqiptarë nga rajonet e mësipërme dhe ngarkimi i disa prej tyre me poste në qeverinë e parë shqiptare është një dëshmi. (Mehmet Dërralla nga Tetova ka qenë ministër i parë i mbrojtjes. Ndërsa pjesmarrja në Vlorë e Boletinit apo Muharrem Rushitit nga Camëria dhe Kosova është një dëshmi tjetër, për çka u tha më lartë).

Por Konferenca e Londrës në mesin e vitit 1913 vendosi ndryshe. Në mënyrë artificiale dhe me të drejtën e forcës, ajo me shtet shqiptar njohu Shqipërinë aktuale që jetojmë sot. Ndërsa shqiptarët e tjerë dhe tokat e tjera shqiptare i përdori ose për të formuar shtete artificiale ose për të zgjeruar shtete të tjera.

Përgjatë një shekulli shqiptarët kanë festuar gjithmonë 28 nëntorin e vitit 1912 dhe jo vendimet e Konferencës së Londrës. Në thelb kanë festuar një ëndërr, por jo një realitet. 28 Nëntori 1912 është ëndërra. Konferenca e Londrës është realiteti.

Cilin do të festojnë shqiptarët në fund të vitit 2012 apo fillim të vitit 2013: Ëndërrën e një realiteti të supozuar, realitetin absurd apo realitetin e ri?

Shqipëria natyrale pjestohet për pesë

Qysh prej vitit 1913 të cilin Kadare e konsideroi me të drejtë Vit i Mprapshtë, shqiptarët shtuan këngët dhe mitet. Ajo që mungonte në realitet u kompensua në këngë apo mite. («Sa kombe ka në botë baba?» Kështu ju drejtua Natan Rotshildit, djali të Amshel Majerit, themeluesit të shtëpisë më të pasur në botë «Natani dhe bijtë», djali i tij. Dhe Natani ju përgjigj : «Dy more bir dhe mos e harro këtë : Hebrejtë dhe të tjerët». Ky mit i

mbajti gjallë si komb hebrejtë për shekuj me radhë deri sa u kthyen në tokën e të parëve në vitin 1948 dhe krijuan shtetin e tyre të Izraelit)

Ndërsa shqiptarët krijuan dy Shqipëri, një në këngë e cila u quajt Shqipëria Etnike. (Shqipëria Etnike që ishte vetëm në këngë dhe histori u shtri deri në Nish në Veri dhe deri në Pargë e Prevezë në Jug) E dyta ishte dhe është Shqipëria Aktuale. (Në vitet 1941-1944 përkohësisht na dhanë edhe një realitet të ri : Shqipërinë aktuale plus prefekturën e Prishtinës, të Pejës dhe Prizrenit që e konsideruan Shqipëri të Madhe.)

Deri në vitin 1991, shqiptarët jashtë Shqipërisë aktuale jetonin në shtetin artificial të quajtur Jugosllavi. Pas fillimit të shpërbërjes së saj ata u pjestuan për katër. Duke shtuar edhe pjestimin e parë të Konferencës së Londrës, pjestimi i shqiptarëve është bërë për pesë. (Do të mjaftojë vetëm një shembull për çka thashë më lart: Maqedonia që është sot me emrin FYROM u bë shtet i pavarur duke përfshirë në gjirin e saj 600 mijë shqiptare. Në një kohë që mund të shmangej ky artificë po të bashkohej me pjesët e saj natyrale, si Maqedonia e Pirinit që është në Bullgari dhe Maqedonia e Egjeut që është në Greqi.

Rezistenca në Kosovë, kërkesa për të drejtën themelore të një populli që është e drejta e vetvendosjes si dhe përpjekja e regjimit serb për ta çuar artificialitetin e shtetit të quajtur Jugosllavi deri në absurd, realizoi kalimin nga rezistenca pasive në atë aktive me emrin UCK dhe më vonë në ndërhyrjen e NATO-s. Sot Kosova është në prag të pavarësisë me synim për të krijuar një shtet të dytë shqiptar, ngjitur me Shqipërinë aktuale.

Shqiptarët në Maqedoni pasi fituan disa të drejta pas vitit 2001, duket se duan ti humbasin ato me shpejtësi gjoja në emër të një jetë më të mirë. Ndërsa shqiptarët në Mal të Zi, pasi i dhanë dorën e fundit pavarësisë së një shteti të huaj, duket se do të provojnë që vërtet janë të huaj. Janë të pranueshëm si banorë, por të papranueshëm si qytetarë apo si kombësi. Shqiptarët e Luginës së Preshevës pas luftës së vitit 99-2000, morën shumë në letër, por pak në praktikë.

E përbashkëta e gjithë hapsirës shqiptare është se politikanët që i kanë përfaqësuar ata, asnjëherë nuk kanë kërkuar zgjidhjen e problemit shqiptar në mënyrë tërësore, por pjesore. (Politikanët e huaj kanë qenë dhe janë më të zgjuar. Në vitin 1913 ata e krijuan problemin shqiptar në mënyrë tërësore. Me një vendim të vetëm, Kosova, Ulqini, Lugina e Preshevës, Pollogu, Çamëria etj u lanë jashtë Shqipërisë. Ata kështu veprojnë edhe sot. Ka ndryshuar forma e veprimit por jo thelbi i tij).

Jetojmë në një realitet të ri. Brenda këtij realiteti, pavarësia e Kosovës është pak, liritë dhe të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni, Mal të Zi apo Serbi njohja e të drejtave të çamëve në Greqi janë pak. Kush është pjestuar për pesë duhet të shumëzohet me pesë. Kështu duhet të ndodhë edhe me shqiptarët. Shumëzimi i tyre me pesë do të thotë Shqipëri Natyrale, do të

thotë paqe dhe stabilitet rajonal. Duke kërkuar Shqipërinë Natyrale si një të drejtë të pamohueshme, shqiptarët nuk janë kundër as Serbisë natyrale, as Malit të Zi natyral, as Maqedonisë natyrale etj etj.

Maqedonia do të ndahet ... (Intervistë dhënë gazetës Epoka e Re datë 9-10 gusht 2006)

EPOKA E RE: Si e shihni Maqedoninë pas zgjedhjeve të fundit parlamentare mund të na thoni sa mendoni se mund të jetë e qëndrueshme qeveria e re e Shkupit?

Danaj: E shoh me një fytyrë të re dhe me parashikimin e një thelbi të ri.

Cila është kjo fytyrë do të thoni? Po është fytyra e braktisjes së Marrëveshjes së Ohrit, është fytyra e heqjes dorë nga identiteti kombëtar shqiptar në emër të një jete më të mirë. A nuk do të thotë këtë Gruevski kur deklaroi se ekonomia do të jetë prioriteti i tij. Që do të thotë sipas nxënësit të Dimovskës dhe mikut të Georgievskit se përkatësia etnike nuk ka rëndësi, rëndësi ka buka e gojës. Pra, fytyra e qeverisë Gruevski duket që do të jetë fytyra e atij që shqiptarët i konsideron banorë dhe jo popull. Mjerisht politikanët shqiptarë në Maqedoni kanë harruar se në shtetet shumetnike ka dy opozita

EPOKA E RE: Ali Ahmeti edhe pse fitoi në kampin politik shqiptar mbeti jashtë qeverisë së Maqedonisë. Mendoni se janë të qëlluara protestat e filluara nga BDI-ja?

Danaj: Protesta është një mjet i luftës politike. Dhe sa kohë që ajo nuk është e dhunshme, është normale. Ahmeti dhe partia e tij po ndëshkohen nga ajo pjesë e pa zbatuar e Marrëveshjes së Ohrit, ku edhe BDI-ja ka përgjegjësinë e saj kryesore krahasimisht me PDSH-në.

EPOKA E RE: Cila është kjo?

Danaj: Është ajo pjesë, e cila partitë politike shqiptare i trajton si bisht të politikës maqedonase dhe jo pjesë përbërëse e politikës së Maqedonisë. Qysh nga viti 1991 që të gjithë, Haliti, Imeri, Xhaferi, Ahmeti, Vejseli në kohë të caktuar kanë pranuar të jenë bisht i politikës së Maqedonisë.

EPOKA E RE: Çfarë doni të thoni me këtë?

Danaj: Dua të them se për partitë politike shqiptare në Maqedoni nuk ka pasur rëndësi se sa vota kanë marrë nga elektorati i tyre, por sa vota ka marrë partia maqedonase me të cilën ata kanë pasur atë që ata e quajnë përputhje të bindjeve politike. Dhe këtu qëndron demagogjia e partive politike shqiptare në Maqedoni përballë shqiptarëve. Kur ka qenë momenti për pushtet dhe karrige pushteti, krrerët e këtyre partive kanë nxjerrë në plan të parë bindjet politike të majta apo të djathta. Ndërsa kur ka qenë momenti për kredibilitet politik përballë shqiptarëve ata kanë nxjerrë në plan të parë gjoja patriotizmin. Është një hendikep i madh i politikës shqiptare në Tetovë. Është një dyfytyrësi, që çështjen shqiptare pranon ta lerë në harresë. Duke u kthyer te përgjigja e pyetjes suaj do të thosha se Ali Ahmeti është pjesë e kësaj politike dhe këtij mentaliteti. Teza e tij mbi kombin politik është një tezë që nuk përkon asfare me çështjen shqiptare. Është një tezë internacionaliste. Për katër vjet, Ahmeti as nuk e parashtrroi ndonjëherë tezën se koalicionet qeveritare në Maqedoni duke qenë në thelb etnike, nuk krijohen mbi përputhshmëri politike, por mbi sasi votash nga secila etni. Ndërsa maqedonasit janë më të zgjuar. Ata i përdorin të dyja edhe përkatësinë etnike edhe bindjet politike, me synim që të mos kërcënohen nga votat e shqiptarëve. Që është kështu mjafton fakti që "djathtisti" Gruevski për të bërë shumicën në Parlament ka thirrur në qeveri "majtistin" Petkovski, "djathtistin" Xhaferi etj. Mjerisht politikanët shqiptarë në Maqedoni kanë harruar se në shtetet shumë etnike ka dy opozita: Njëra është opozita etnike dhe e dyta është opozita politike. Ato plotësojnë njëra tjetrën, por nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën siç kanë vepruar politikanët

shqiptar në Maqedoni gjatë 15 vjetëve.

Sfidat e qeverisë së re të Maqedonisë

EPOKA E RE: Cilët janë sfidat me të cilat do të ballafaqohet qeveria e re e Maqedonisë dhe cili mendoni ju se do të jetë pozicioni i PDSH-së në këtë qeveri. Mendoni se PDSH-ja bëri kompromis për të hyrë në qeveri?

Danaj: Ka një kamuflim diabolik të qeverisë së Nikolla Gruevskit. Ai flet për një program ekonomik ambicioz, i cili ka filluar të evidentohet edhe nga PDSH-ja. Por problemi themelor i Maqedonisë nuk është programi ekonomik, por ai etnik. Spostimi që po i bën Gruevski aspektit etnik dhe përkrahja që po merr në këtë diabolizëm politik nga shqiptarët është paralajmërimi i destabilizimit dhe ndarjes së Maqedonisë. Problemet nuk ekspotohen atje ku dëshiron dikush apo disa, por ato zgjidhen atje ku janë. Pikëpamja e parë është Çeguevarizëm, e dyta është realizëm. Çeguevaristi i VMRO-së, Gruevski është ai që së bashku me 409 mijë maqedonas ka votuar kundër Marrëveshjes së Ohrit në referendumin famëkeq. Këtë e di gjithkush nga shqiptarët dhe politikanët e tyre. Atëherë: A janë ata dakord me këtë Marrëveshje, apo pushteti vlen më shumë se një Marrëveshje? Ndërsa lidhur me atë se a bëri apo jo kompromis PDSH-ja, kjo është fare e thjeshtë: PDSH-ja ka bërë kompromis, por se çfarë synon kjo do të duket të paktën pas një viti. Uroj të jenë në të mirë të çështjes shqiptare.

Deklarata e çuditshme e Arbën Xhaferit

EPOKA E RE: Arbën Xhaferi ka paralajmëruar tërheqjen nga politika nëse PDSH-ja hyn në qeveri. Si e shihni të ardhmen e kësaj partie pa Xhaferin?

Danaj: Është një deklaratë e çuditshme dhe me shumë pikëpyetje nga pas, për ata që kanë kohë që e njohin Arbën Xhaferin. Por është e drejta e tij të tërhiqet tani që rimori pushtetin. Por personalisht nuk më duket një mendim i qëlluar dhe në kohën e duhur.

EPOKA E RE: Pse e thoni këtë?

Danaj: Sepse po ta pranojmë si të saktë pohimin e tij që do të tërhiqet nga politika tani që PDSH-ja hyri në qeveri, kjo është komprometuese për vetë Xhaferin.

EPOKA E RE: Pse është e tillë?

Danaj: Sepse do të na duhet të pohojmë se e gjithë lufta politike e Arbën Xhaferit për çështjen shqiptare paska qenë e pa vërtetë, se Arbën Xhaferi nuk na qenka ideologu i çështjes kombëtare shqiptare, por një ideolog pushteti, se ai paska luftuar thjeshtë për të avancuar në pushtet disa nga njerëzit e tij etj., etj. Ky është problemi i parë dhe më kryesor. Të tjerat nuk kanë rëndësi fare.

EPOKA E RE: Besoni në këtë lloj arsyetimi?

Danaj: Personalisht nuk e besoj këtë lloj arsyetimi, sepse e njoh mirë Arbën Xhaferin. Por nuk do të thotë aspak se meqë nuk e besoj unë që njoh Xhaferin, problemi nuk ekziston në vetvete. Zëvendësimi i ideologut kombëtar me pushtetarin provincial është një

problem në tërësi për çështjen shqiptare në të gjithë hapësirën shqiptare. Edhe kur kërkon të jesh ideolog i të gjithëve siç ka vepruar Xhaferi, nuk të lënë të tjerët. Ndoshta është një deklaratë nën trysni. Por le të presim.

EPOKA E RE: Çka mendoni se duhet të bëhet që t'u iket zënkave brendakorpussit politik shqiptar në Maqedoni?

Danaj: Është e thjeshtë. E para dhe e fundit: politikanët shqiptarë në Maqedoni kanë nevojë të heqin dorë nga mentaliteti bajraktar se kush është i pari. Pas kësaj çdo gjë është shumë e thjeshtë. Për vendin e dytë nuk lufton njeri deri në mëri apo grindje.

EPOKA E RE: Më herët keni deklaruar se moszbatimi i Marrëveshjes së Ohrit do të thotë ndarje e Maqedonisë. Mund ta elaboroni më shumë këtë tezë tuajën?

Danaj: Po e kam thënë në një analizë të botuar kohët e fundit. Mendoj se edhe në politikë dhimbja e së vërtetës është më e lehtë se dhimbja e mashtrimit. Prandaj po e ritheksoj se moszbatimi i Marrëveshjes së Ohrit do

të thotë ndarja e Maqedonisë. Duket se ky do të jetë edhe qëllimi i koalicionit qeveritar në Maqedoni. Në mars-prill 2001, regjisori-kryeministër i Maqedonisë, Ljubço Georgievski kërkoi ndarjen e saj në kushte të favorshme për atë dhe të pafavorshme për shqiptarët. Por Arbër Xhaferi nuk e pranoi këtë tezë. Ndërsa në maj 2001 kur UÇK-ja kishte zotëruar Luginën e Vardarit, Georgievski u tërhoq vetë dhe ngarkoi Akademinë e Shkencave për të mbajtur gjallë tezën e ndarjes së saj. Gazeta "Veçer" e datës 25 maj 2001 botonte hartën e ndarjes së Maqedonisë. Janë të njohura arsyet përse nuk u realizua ky skenar atë vit. Por skenari ekziston akoma.

Maqedoninë do ta qeverisin ata që ishin dhe janë kundër Marrëveshjes së Ohrit

EPOKA E RE: Përse ekziston ky skenar sipas mendimit tuaj?

Danaj: Sepse Maqedoninë do ta qeverisin ata që ishin dhe janë kundër Marrëveshjes së Ohrit, vartësit e Lube Boshkovskit dhe Ljubço Georgievskit. Dhe në thelb Marrëveshja e Ohrit është shumë herë më dimensionale se sa është trajtuar deri më sot. BDI në mjaft raste e harroi këtë tipar të saj dhe e trajtoi si marrëveshje të njëanshme.

EPOKA E RE: Mendoni se kjo marrëveshje ishte vetëm për shqiptarët?

Danaj: Kjo Marrëveshje nuk ishte vetëm për shqiptarët. Është një kamuflim i gabuar trajtimi i saj si marrëveshje vetëm për shqiptarët. Për më shumë, kjo marrëveshje që pas disa ditësh ka 5 vjetorin shpëtoi Maqedoninë nga shpërbërja. Të harrosh këtë thelb të marrëveshjes do të thotë t'i hapësh rrugë shpërbërjes së Maqedonisë aktuale.

Marrëveshja e Ohrit - mësim i madh për gjithë politikanët në Ballkan

EPOKA E RE: Mendoni se Marrëveshja e Ohrit ishte një mësim që duhet ta mësojnë edhe maqedonasit dhe politikanët e Shkupit?

Danaj: Marrëveshja e Ohrit ishte edhe një mësim i madh, jo vetëm për shqiptarët dhe maqedonasit dhe politikanët e tyre, por edhe për të gjithëpolitikën në Ballkan, mbi atë se

si bëhet dhe duhet bërë kompromisi dhe dialogu. Për të arritur deri te Marrëveshja e Ohrit, politikanët maqedonas dhe ata shqiptarë u mësuan të bëjnë dialog me këdo, dialog për gjithçka për të arritur deri te kompromisi. Dhe duhet thënë se politikanët maqedonas dhe shqiptar, kompromisin e realizuan në fund.

EPOKA E RE: Po, çka mendoni ju për këtë kompromis?

Danaj: Kompromisi i tyre nuk ishte thjesht i detyruar siç ka ndodhur shpesh në mjediset politike ballkanike. Kompromisi i detyruar mbartë në thelb trysninë ndërkombëtare, prandaj edhe është shkelur në mjaft raste. Ndërkaq kompromisi i dëshiruar, mbart edhe nevojën e popujve, etnive, komuniteteve apo bashkësive etj. për të jetuar së bashku, për të rregulluar së bashku mosmarrëveshjet. Marrëveshja e Ohrit është një kompromis jo vetëm i detyruar nga bashkësia ndërkombëtare, por edhe i dëshiruar nga bashkësia maqedone, shqiptare etj., etj.. Gruevski po i ikën Marrëveshjes së Ohrit. Dhe kjo do të thotë se po i hap rrugë shpërbërjes së Maqedonisë.

Dosja Kosovë...

EPOKA E RE: Pse nuk u nda Maqedonia në vitin 2001?

Danaj: Nuk u nda, sepse ende nuk ishte hapur "Dosja Kosovë", që është dosja kryesore jo thjesht ballkanike, por më shumë se kaq. E tani kjo dosje është në pragun e mbylljes. Duke qenë kështu, në qeverinë e Maqedonisë duhet të ishte dhe është një parti politike shqiptare me prirje nacionaliste siç është PDSH-ja dhe jo një parti me prirje qytetare si BDI-ja. Por në qoftë se dikush thotë se si do të qëndronte Maqedonia pa një të tretën e saj, më duhet të pohoj se përderisa BE-ja dhe SHBA-ja pranuan të formohet një shtet me 600 mijë banorë si Mal i Zi, pse të mos pranojnë edhe një shtet maqedonas me mbi një milion banorë. Por, përsëri, në qoftë se dikush do të më thotë se çfarë do të bëhet me mbi 600 mijë shqiptarë, aq sa është i gjithë Mal i Zi, përsëri do të më duhet të pohoj se edhe ky është një problem i zgjidhur. Ata do të jenë të lirë ose të bashkohen me mëmëdheun që është Shqipëria ose me një pjesë të atdheut që është Kosova.

EPOKA E RE: Mendoni ju se kjo është nacionalizëm?

Danaj: Përsëri edhe në qoftë se dikush apo disa do të thonë se kjo pikëpamje është një nacionalizëm i hapur, do të më duhet të pohoj se sa kohë që çështja shqiptare vazhdon të jetë e hapur, aq kohë mendimet për zgjidhjen e saj nuk mund të jenë nacionalizëm, por realizëm dhe europeanizëm i kulluar. Po sjell një shembull në vëmendjen tuaj: Deri më sot 5 shtete që jetojnë në rajonin e Ballkanit në të cilat ka edhe shqiptar diku si shtet, diku si mazhoritet dhe diku si minoritet, janë ndërtuar mbi shtatë marrëveshje ndërkombëtare. Por që asnjëra prej tyre nuk është bërë natyrale, por vazhdojnë të mbeten artificiale. Mbi këtë bazë njohjeje, është normale që shumëkush të jap mendime dhe gjykime për një marrëveshje përfundimtare lidhur me këto 5 shtete ku jetojnë shqiptarë, e cila marrëveshje të jetë natyrale. Jam i bindur se edhe bashkësia ndërkombëtare do të dëshironte një gjë të tillë. Do të mjaftonte vetëm një shembull për t'u bindur kushdo se bashkësia ndërkombëtare do të ishte dakord me atë që thashë më lartë.

EPOKA E RE: Po cili është shembulli Danaj?

Danaj: Sot në hapësirat shqiptare ka dy presidentë, një në Shqipëri dhe një në Kosovë, dy

kryeministra, një në Shqipëri dhe një në Kosovë, 3 zëvendëskryeministra, një në Shqipëri, një në Kosovë, një në Maqedoni, 30 ministra, nga të cilët 14 në Shqipëri, 11 në Kosovë, 4 në Maqedoni dhe një në Mal të Zi. Pa folur për mbi 70 zëvendësministra. Kushdo nga bashkësia ndërkombëtare do të pranonte më mirë vetëm një president, një kryeministërdhe 15 ministra.

E ardhmja e Maqedonisë është ndarja në vitet 2010-2012 pavarësisht kundërshtimeve të Ali Ahmetit

EPOKA E RE: Cila është e ardhmja e Maqedonisë, sipas jush?

Danaj: E ardhmja e kësaj Maqedonie që është sot siç thashë edhe më lartë, duket se do të jetë ndarja e saj në vitet 2010-2012, pavarësisht kundërshtimeve të Ali Ahmetit. Ndërsa e ardhmja e Maqedonisë që do të mbetet pas këtyre viteve do të jetë integrimi evropian i saj. Ndërsa e ardhmja e një të tretës së Maqedonisë që do të jenë shqiptarët do të jetë përsëri shpresëdhënëse. Ata shpresoj se në vitin 2013 do të jenë të gjithë të integruar në Shqipërinë natyrale. Dhe për ta mbyllur do sillja në vëmendjentuaj disa vargje nga eposi i ditëve të fundit të krahinës së Himarës: Ne ëndërr të madhe nuk kemi; Veç folenë ku fle Shqiponja ; Shqipërinë Natyrale; Katër Vilajetet tona.

Le të takohemi fillimisht në Shqipërinë Natyrale (Intervistë e kryetarit të AMS dhe drejtor i IPPS, Koço Danaj dhënë gazetës Epoka e Re datë 24 gusht 2006)

Pyetje: Ministri i Jashtëm serb Vuk Drashković ka dalë para mediave me një deklaratë lidhur me intervistën tuaj dhënë në "Epoka e re". Si i komentoni ju tezat e tij?

Danaj: Deklarata e Ministrit të Jashtëm Serb Vuk Drashković, është një deklaratë jashtë realitetit të Ballkanit në tërësi. Është një deklaratë e tipit të granatave tymuese që kanë vetëm efekt për bërjen tym, dhe nuk metojne te shtrojnë dhe të pozojnë asnjë problem. Pra është një deklaratë të cilën do ta quaja arratisje nga realiteti i Ballkanit ne teresi

Intervista
e dhene ne gazeten Epoka e Re ka pasur me shume si objekt zhvillimet politike ne Maqedoni dhe gjate trajtimit eshte perdorur termi Shqiperi Natyrale. Ne ate interviste une jepja mendimin tim se çdo anashkalim i thelbit te Marreveshjes se Ohrit nuk eshte gje tjeter veçse fillimi i ndarjes se Maqedonise. Duke qene se i njoh mire rrethanat ne te cilat u arrit kjo marreveshje, sot pas 5 vjetesh, pohoj se ajo mban ne kembe vete shtetin e Maqedonise. Ajo nuk ishte marreveshje vetem per shqiptaret, por edhe per vete maqedonasit. Mendimi dhe analiza nuk jane vendime dhe realiteteMirëpo, Drashković e anashkalon kete analize dhe fantazon me strategjine e Shqiperise natyrale. Pra eshte nje deklarate me diabolizem brenda.

Pyetje: Përse?

Danaj: Po ja përse: Kjo deklaratë, mendimet personale të mijat si drejtues instituti, si kryetar partie si qytetar, si politolog, përpiket t'i servojë si mendime dhe platforma zyrtare të Shqipërisë dhe politikës së saj. Aq e trashë është kjo përpjekje sa, Drashković, nuk ka

marrë as të dhëna se kush jam unë, duke më trajtuar si këshilltar të kryeministrit Sali Berisha, gjë që nuk është e vërtetë. Siç e kam thënë edhe për gazetën "Epoka e re", unë kam qenë këshilltar politik me ish-kryetarin e PSSH-së Fatos Nanon dhe me ish-kryeministrin Ilir Metën. Tani jam drejtor i Institutit të Prognozave rajonale dhe njëherësh kryetar i Partisë Aleanca për Mirëqenie dhe Solidaritet (AMS). Duket se atë e tremb termi real "Shqipëri Natyrale", e cila nuk ka cilësoret artificiale "E Madhe apo Etnike", por vetëm atë që është cilësori reale, natyrale. Por ky nuk është faji im. Shqiptaret nuk mund të sakrifikohen me neper altare të tjerëve.

Pyetje: I paraqisni ju më të vërtetë qëndrimet zyrtare të Tiranës në këtë intervistë?
Danaj: Jo, sepse nuk kam se si t'i shpreh këto qëndrime. Qëndrimet zyrtare i shpreh qeveria, presidenca, pra institucionet e shtetit. Por unë shpreh qëndrimet e mija, dhe me lejoni t'ju them se pas intervistës për gazetën e nderuar "Epoka e re", pashë se ishin me qindra e me mijëra ata që ishin dakord me mendimet e mija. Pra, për mua ka rëndësi që mendimet të jenë reale. Pastaj, politika zyrtare shikon edhe faktorë të tjerë para se të shprehet, dhe njëkohësisht ne kemi nevojë t'i shprehim sa më hapur qëndrimet tona më qëllim që të ndihmojmë edhe politikën tonë zyrtare, por edhe bashkësinë ndërkombëtare. Kudo dhe kurdo kemi dy politika; Njera është politika zyrtare dhe tjetra është politika Reale. Politika reale është me e gjere, ajo te jep mundesi te shprehesh me hapur, me lirshem dhe me qarte. Asaj i mungojne pengesat sepse nku eshte e lidhur me ambiciet pushtetore. Sa me e plote dhe sa me shumedimensionale te jete politika reale, aq me efektive eshte per nje vend politika zyrtare e tij. Për shembull: Janë dy linja që ushtrojnë trysni mbi shqiptarët: Linja e parë është ajo që thotë se ju shqiptarët në Preshevë, Sarandë apo Tetovë, para se të bashkoheni në "Shqipërinë Natyrale", bashkohuni në Evropën e madhe. Bukur, unë jam dakord se bashkimi në Europën e madhe është aspiratë e të gjithë shqiptarëve. Por aspirata nuk është realitet. E shumta ajo krijon virtualitet, krijon enderra, por asesi një realitet ndryshe që behet pararendes i një mentaliteti ndryshe. Perse? Po ja perse: Kur Evropa e madhe thotë se juve shqiptarëve të Shqipërisë andej nga viti 2020 ju vjen radha për tu bashkuar në Bruksel, çfarë duhet të bëjmë neve, a mund të ma thoni? Megjithatë kjo është një linjë politike. Por ka edhe një linjë tjetër politike, të cilën nuk ka pse të druhen për ta përdorur dhe përpunuar. Kush është ajo do të thoni ju? Po ja, është ajo që unë si shqiptar sa të rri dhe të pres bashkimin me "Evropën e Madhe" në vitin 2020, të bëj një punë dhe veprim me të frytshëm

Pyetje: Cila është kjo punë?

Danaj: Po behem me konkret: Duke pritur të integrohemi në Europën e madhe, të mos rrimë duarkryeq, por të fillojmë të integrohemi në fillim në hapësirën shqiptare, që të jemi gati për në Evropën e Madhe. Psh: Përse duhet të pres unë, që jam nga Tepelena, deri në vitin 2015 apo 2020-të, që të integrohem me atë shqiptarin që është nga Malisheva apo Tetova, apo Kumanova apo Likova, apo Sllupçani, apo Tanusha, nga Tuzi apo nga Plave Guxija etj kur këtë mund ta bëj që tani që në vitin 2007, 2010 apo 2012 dhe në Evropë shkojmë së bashku të integruar. Pra edhe kjo është një linjë politike, një vizion mbi integrimin e shqiptarëve?

Pyetje: Kush është e rëndësishme?

Danaj: Ka dy momente te rendesishme:

E para: E rëndësishme është që në zbatimin e këtyre dy linjave, të aplikojmë metoda demokratike, dialogun dhe jo dhunën, forcën e së drejtës dhe jo të drejtën e forcës.

E dyta: Eshte po kaq e rendesishme edhe veprimtaria per integrimet ndershqiptare.

Imagjinoni ju sikur shqiptaret te zbatojne pike per pike ate qe ju thone disa diplomate te fantaksur europiane qe pse shqetesoheni ju

shqiptaret. Ju duhet te prisni te takoheni me njeri tjetrin ne Bruksel. Cinizem me brire.

Dhe po te degjosh ata, atehere do te ndodhe qe shqiptaret asnjehere nuk do te takohen ne Europen e madhe. Sepse shumica e politikanëve europiane qe i duan vendet e tyre dhe integrimet midis popujve te tyre, kurre nuk do te marrin seriozisht kerkesen per integrim te nje populli,

pjestaret e te cilit nuk integrohen me njeri tjetrin dhe jane te huaj per njeri tjetrin? Ata me te drejte do te thone me njeri tjetrin se keta shqiptaret kane ose ndergjegje fisi ose ndergjegje klani, prandaj le te rrine ku jane. Kur te arrijne ndergjegjen e kombit, jane te mireseardhur ne Bruksel. Kjo eshte e verteta. Dhe ne jemi te detyruar ta shprehim kete te vertete, ashtu sic jemi te detyruar te perpiqemi te jetesimin e saj. Eshte nje ndihmese e madhe per kombin te cilit i perkasim dhe per kontinentin nete cilin jetojme.

Duke përfunduar do të thosha se në deklaratën e Drashkovicit ka edhe një djallëzi tjetër.

Ai merr në mbrojtje Malin e Zi, Maqedoninë, bile edhe

Greqinë. Pra del në rolin e atij që nuk e ka hallin e tij, por që i dhimbsen të tjerët. Duket se është një pozitë e dhimbshme e Drashkoviçit, por shqiptarët kanë mjaft dhimbje për vete nga e kaluara. Ata, do të thosha nuk kanë kohë të merren me dhimbjet e stisura të të tjerëve. Rozafa Politike e shqiptarëve është dhe duhet te mbetet objekt i traditës, por jo i realitetit dhe politikës shqiptare.

Per te perfunduar kete interviste me duhet te pohoj se ne vitin 2001, me sa kam mundur kam dhene ndihmesen time qe konflikti ne Maqedoni te civilizohej.

Edhe perkunder atyre qe botonin harta per ndarjen e saj. Por realiteti duhet trajtuar ashtu siç eshte dhe ajo siç mund te doje partia apo propaganda partiake. Te perballosh realitetin do te thote te pergatisesh progresin. Ta fshehesh ate do te thote ti hapesh rruge deformimit te demokracise.

«Shqipëria Natyrale» është një nocion europaerëndimor

Pas përdorimit për herë të parë të nocionit politik Shqipëria Natyrale, u bë një zhurmë e madhe. Në mjedise politike jashtë Shqipërisë ky nocion u barazua me nocionet Shqipëri e Madhe, apo me nocionin Shqipëri Etnike. Ministri i jashtëm i Serbisë Drashkovic arriti deri aty sa njoftoi Grupin e Kontaktit, BE dhe SHBA për rrezikun e Shqipërisë natyrale. Në Parlamentin European në datë 6 shtator 2006, eurodeputeti polak Piniora ju referua nocionit Shqipëri Natyrale duke e konsideruar atë si aspiratë të shqiptarëve. Ndërsa në disa mjedise politike, qytetare dhe mediatike shqiptare u shpreh droja se nocioni Shqipëri Natyrale është i dëmshëm sepse gjoja dëmtoka problemin e Kosovës, apo se sa kohë që Kosova nuk ka fituar statusin e saj ne nuk duhet të flasim. Dhe nuk duhet tju japim gjoja

fakte fqinjëve tanë që të na akuzojnë për nacionalizëm etj etj!! (Në deklaratën e Drashkovic drejtuar Grupit të Kontaktit lidhur me Shqipërinë Natyrale midis të tjerash figuronte shprehja: A nuk jua thamë) Duke i marrë parasysh parashtrimet e mësipërme, duke marrë parasysh se nocionet politike kur hidhen për herë të parë edhe mund të keqkuptohen apo nënkuptohen ashtu siç edhe kuptohen, aq kohë është e nevojshme, pse jo edhe e domosdoshme të sqarohet akoma më mirë përse Shqipëria Natyrale është nocion politik i së ardhmes, progresist dhe në përputhje me realitetin e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ndërtimi i shtetit të Kosovës apo problemet e hapsirave shqiptare në Maqedoni, Luginë të Preshevës apo Mal të Zi, janë hapa në sendertimin e kësaj Shqipërie Natyrale.

Qëllimi i trajtesës

Qëllimi i kësaj trajtese, nuk ka të bëjë thjesht me një nocion, por me nevojën që pas analizës nocioni dora dorës të fillojë të bëhet i pranueshëm për të gjithë shqiptarët dhe për të gjitha ato mjedise ballkanike dhe europiane që janë të interesuar për paqen dhe progresin në rajon. Qëllimi i kësaj trajtese është që Shqipëria Natyrale të pranohet nga të gjithë si moderne dhe bashkëkohore. Dhe që pas trajtesës, duke u pranuar si e tillë hap pas hapi dhe dora dorës të fillojë sendertimi i saj si përmbyllje e integritimeve rajonale dhe pikënisje e atyre europiane. Atëherë le të fillojmë nga trajtesa e cila do të na kërkojë që të kthehemi një shekull pas për të parë se si është ndërtuar dhe si funksionon rajoni i Ballkanit.

Marrëveshjet që kanë krijuar shtetet e Ballkanit Perëndimor

Analiza e marrëveshjeve mbi të cilat janë ndërtuar shtetet e Ballkanit perëndimor do të na ndihmojë për të parë më mirë të gjithë atë artificialitet të marrëveshjeve duke na dhënë imperativin e Marrëveshjeve Natyrale.

Le ti marrim me radhë duke anashkaluar Kongresin e Berlinit :

E para: Marrëveshja e Londrës 1913:

Fuqitë e mëdha vendosin krijimin e shtetit të ri shqiptar duke i dhënë atij karakterin e një shteti neutral. Por duke lënë jashtë kufijve të tij hapsira të mëdha natyrale shqiptare. Teza e sapothënë është e pranuar nga vetë nënshkruesit e Konferencës së Londrës, por e justifikuar për hir të paqes europiane. (Në fakt kjo ishte një mashtrim i madh sepse pas një viti filloi

Lufta e Parë Botërore.) Shqiptarëve ju imponua kjo marrëveshje. Sot mbas një shekulli ajo ka mbetur një marrëveshje artificiale.

E dyta: Marrëveshja e Versajës 1919:

Fuqitë e mëdha pas Luftës së Parë Botërore hartuan Marrëveshjen për Ballkanin dhe vendet që jetojnë në Ballkan. Marrëveshja eliminoi pavarsinë e Malit të Zi dhe krijoi mbretërinë serbo-kroato-sllovene, që në 1927 u quajt Jugosllavi. Ndërsa Malazazët pas kryengritjes së përgjakshme të Krishtlindjeve midis jeshileve dhe të bardhëve, ju drejtuan

eposit dhe kombin malazez e bënë hyjnor në këngë. Të njëjtën gjë bënë edhe shqiptarët të cilët në mungesë të realitetit që përsëri i cungoi nuk munguan që kombin e tyre ta quanin hyjnor. Të njëjtën gjë bënë edhe maqedonasit të cilët 10 ditët e Republikës së Krushevës i quanin si ditët e Ballkanit të paqes me qendër maqedonasit. Pas një shekulli, me shumicën e saj Marrëveshja e Versajës nuk ekziston më. Maqedonia fitoi pavarsinë. Sllovenia fitoi pavarsinë, Kroacia fitoi pavarsinë. Ndërsa Malit të Zi ju kthye pavarsia. Kjo marrëveshje ka mbetur akoma si e tillë imponuese dhe artificiale vetëm për shqiptarët. Trojet shqiptare si Kosova, Lugina e Preshevës, trojet në Mal të Zi apo në Maqedoni akoma nuk janë shkëputur nga artificialiteti i saj. Prandaj ata kanë të drejtë të kërkojnë atë që ju mungon.

E treta. Marrëveshja Ribentrop-Ciano dhe Shqipëria e Madhe

Shqipëria u pushtua nga Italia në vitin 1939. Në Prill të vitit 1941 divizionet e motorizuara gjermane pushtuan Jugosllavinë duke përfshirë edhe Kosovën që ishte pjesë e saj. Më pas në Vienë arrihet Marrëveshja midis ministrave të jashtëm të Gjermanisë dhe Italisë për ndarjen e teritoreve të Ballkanit. Kjo Marrëveshje mori emrin Marrëveshja Ribentrop-Ciano. Sipas kësaj Marrëveshje trupat gjermane u larguan nga pjesa më e madhe e teritorit të Kosovës duke mbajtur Vushtrinë, Podujevën dhe Mitrovicën të cilat ju dhanë Serbisë. Serbia aso kohe qeverisej nga një qeveri e kryesuar nga ish shefi i shtatmadhorisë së ushtrisë jugosllave Milan Nediç. Kufiri sipas Marrëveshjes u vendos në Mitrovicë, ku qeveria e Nediçit dislokoj një batalion të Rojes Shtetërore meqë sipas Marrëveshjes aty ishte kufiri me Shqipërinë. Një pjesë tjetër e Kosovës aktuale ju dha Bullgarisë së Car Borisit që ishte aleate e gjermanëve. Përveç Maqedonisë Lindore, Bullgaria mori si teritor të saj Luginën e Preshevës, Shterpcën, Kaçanikun, Kumanovën dhe Vitinë. Ndërsa pjesa tjetër e Kosovës dhe e Maqedonisë u bashkua me Shqipërinë. Italia në këto teritore krijoi katër prefektura. Prefektura e Prishtinës, e Pejës e Prizrenit dhe e Dibrës. Nga kjo Marrëveshje dhe nga kjo ndarje teritori u krijua ajo që u quajt Shqipëri e Madhe. Këtë term shqiptarët vazhdojnë ta dëgjojnë edhe sot, sa herë që duhet që nga ata kërkohet të mbyllin gojën apo sa herë që ata duhet të përçahen. Shqipëria e Madhe sipas të vërtetës historike është Shqipëria e sotme administrative plus Prefekurën e Prishtinës, plus atë të Prizrenit, plus atë të Pejës dhe minus Preshevën, minus Bujanovcin, minus Kaçanikun, minus Vitinë, minus Kumanovën, minus Mitrovicën, minus Urën e Ibrit, minus Vushtrinë, minus Podujevën, minus Ulqinin, minus Tuzin dhe Malsinë dhe dhjetra minuse të tjera.

E katërta : Mbarimi i Luftës së Dytë Botërore dhe Marrëveshja e Jaltës dhe Potsdamit.

Rikthehet ish-Jugosllavia më e fuqishme se më parë. Influenca ruso-anglo-amerikane u nda 50 me 50 përqind, gjë që solli përkrahjen e saj nga të dy bloqet dhe marrjen e drejtimit të Lëvizjes së të paangazhuarve. Por pas 50 vjetësh rezultoi se ishte një krijesë artificiale dhe filloi shpërbërja e saj që fatkeqësisht rezultoi e përgjakshme. Sot nuk

ekziston asgjë nga Marrëveshja e Jaltës. Asnjë lloj natyralizimi. Vetëm artificialitet.

E pesta : Marrëveshja e Dejtonit.

Është një marrëveshje që rregulloi marrdhëniet midis serbëve, boshnjakëve dhe kroatëve të Bosnjës, pas disa vitesh lufte të përgjakshme dhe gjenocidi mes njëri tjetrit. Është një marrëveshje artificiale dhe imponuese që vazhdon të respektohet për shkak të forcave të NATO të dislokuara dhe të kompetencave të jashtëzakonshme të të dërguarit të BE. 7 vjet pas nënshkrimit të saj, askush prej serbëve, kroatëve dhe boshnjakëve nuk beson tek natyralizimi i saj.

E gjashta: Marrëveshja e Rambujesë e vitit 1999.

Është një marrëveshje e firmosuar vetëm nga shqiptarët. Por e pa firmosur nga serbët. Edhe sot vazhdon të jetë e tillë. Prandaj nuk ka asnjëvlerë.

E shtata: Marrëveshja e Kumanovës

Është marrëveshja që nënshkrua nga NATO dhe Ushtria serbe për të lejuar dislokimin e NATO në Kosovë. Sot pas 7 vjetësh, duket se edhe ajo është një marrëveshje artificiale. Pohimet dhe deklaratimet e politikanëve të ndryshëm kosovarë që Mitrovica e Veriut dhe Kosova Veriore është ndarë qysh në Kumanovë, dëshmojnë mbi karakterin artificial të saj.

E teta : Marrëveshja e Ohrit është marrëveshja që vendosi paqen në Maqedoni dhe synoi të rregullojë marrdhëniet shtetërore dhe shoqërore të shtetit të quajtur Maqedoni. Por duket se edhe kjo marrëveshje do të ketë të jetën e shkurtër. Cilat janë arsytet?

1: Nga politika maqedonase, kjo Marrëveshje vazhdon të konsiderohet si një lëshim që shteti dhe populli maqedonas u ka bërë shqiptarëve. Pra e ka hequr nga vehtja e tij dhe ja ka dhënë dikujt tjetër. Vetëm analiza e faktit që gjatë 5 vjetëve zëvendëskryeministri që merret me zbatimin e saj është vetëm shqiptar të çon në konkluzionin e sipërthënë. Në fillim Musa Xhaferri dhe tani Imer Selmani janë zëvendëskryeministra që ndjekin zbatimin e saj. Në një kohë kur kjo marrëveshje u konceptua dhe nënshkrua si marrëveshje për të ardhmen e dy popujve.

2 : Vetëm dy vjet pas nënshkrimit të saj dhe në prag të fillimit të zbatimit, Kongresi Botëror Maqedonas dhe ish-partitë opozitare të drejtuara nga Gruevski- Andovi dhe Georgievski organizuan një referendum kundër kësaj Marrëveshjeje. Referendumi dështoi, por ai gjithsesi pohoi një fakt të fshehur deri atëherë. Cili është fakti? Kundër kësaj marrëveshje votuan 409

mijë qytetarë me kombësi maqedonase. Shifra e mësipërme është gati e barabartë me votat që morën sëbashku në zgjedhjet e fundit parlamentare, VMRO-DPMNE e Gruevskit plus VMRO popullore e Geogievskit. Edhe në konferencën e organizuar me rastin e 5 vjetorit të saj, në mënyrë indirekte, kryeministri maqedonas Gruevski u shpreh kundër saj duke thënë se personalisht nuk e arsyeton përdorimin e forcës për arritjen e kërkesave politike. (Pra nuk e pranon luftën e vitit 2001 midis UÇK dhe forcave

qeveritare, luftë që solli Marrëveshjen e Ohrit)

Pra edhe kjo marrëveshje është larg të të qenit natyrale dhe shumë pranë artificialitetit. Analiza e programit qeveritar të kryeministrit Gruevski të çon në pohimin se Marrëveshja e Ohrit po bëhet gati të shndërrohet në një ikonë dhe të jetë vetëm objekt i kujtesës historike.

Cili është bilanci?

Këto janë 8 Marrëveshjet Ndërkombëtare mbi të cilat funksionojnë shtetet e Ballkanit Perëndimor. Por cili është bilanci i tyre? Bilanci i përgjithshëm është se ato kanë mbetur vetëm marrëveshje imponuese. Asnjëra prej tyre nuk është natyralizuar. Cila është arsyeja? Ka shumë. Por përmendja vetëm e njërës mjafton. Cila është kjo? Asnjë nga këto variante nuk i zgjidh

problemet midis popujve të Ballkanit por e shtyn zgjidhjen e tyre. Kjo shtyrje problemesh më vonë në fjalorin politik u formësua në nocionin

politik: Ballkani-fuçi baruti. Marrëveshja e Londrës që krijoi shtetin shqiptar mbeti artificiale. Jo

thjesht për cungimin e hapsirave natyrale shqiptare, por edhe për faktin se nuk zbatoi parimin e neutralitetit lidhur me shtetin shqiptar. Marrëveshja e Versajës tregoi që ishte plotësisht artificiale. Sot nuk

ekziston mbretëria serbo-kroato-slllovene. Por janë disa shtete, nga të cilët i fundit ishte Mali i Zi, që janë krijuar. Marrëveshja e Jaltës mbi Ballkanin rezultoi se ishte përsëri artificiale. Jugosllavia e konsoliduar në Jaltë sot është pjesë e memories historike dhe jo e realitetit. Marrëveshja e Dejtonit duket se është artificiale dhe mbahet në këmbë me forcën e bajonetave. Fitorja e forcave nacionaliste në zgjedhjet e fundit në të tria etnitë, tregoi se kemi të bëjmë me një marrëveshje artificiale.

Pra bilanci i 8 marrëveshjeve përgjatë një shekulli tregon se ato nuk arritën të bëhen natyrale. Dhe nuk u bënë të tilla sepse u imponuan mbi shumicën e popujve të Ballkanit.

Prandaj që në këtë rajon kemi shtete të

panatyrshme të cilët në disa raste mbahen në këmbë me hapsira shqiptare dhe popull shqiptar.

Marrëveshje imponuese edhe në fillim shekullin e 21-të

Duket se politika euroamerikane nuk heq dorë nga marrëveshjet dhe politikat imponuese edhe në zgjidhjen e problemeve të Ballkanit të fillim shekullit të 21-të. Duket se pak prej politikanëve ndërkombëtarë që merren me Ballkanin i ka studiuar Marrëveshjet e kaluara. Ose pasi i kanë studiuar, për egoizëm politik nuk e pranojnë dështimin, për të riparuar atë. Është pikërisht ky handicap i kësaj politike që pasqyrohet akoma me metoda imponuese në Ballkan. Midis shumë dhe shumë problemeve, sot flitet për ndërtimin e një Kosove shumëetnike. Është një nocion politik që herë herë kondicionon zgjidhjen e statusit të Kosovës. Por a është real? Nuk është real dhe prandaj nuk është i zbatueshëm. Është artificiale dhe prandaj krijon probleme atje ku nuk ka të tilla. Po pse është artificiale? Po është artificiale se në Kosovë ka vetëm një etni, që janë shqiptarët. Ashtu siç ka disa

pakica

kombëtare siç janë serbët, boshnjakët, turqit etj. Ky realitet nuk e pranon nocionin Kosovë shumëetnike. E megjithatë, ngulet këmbë nga politikanë ndërkombëtarë. Dhe ngulet këmbë në një gjë artificiale. Po pse është e tillë, artificiale? Po është e tillë sepse politika euroamerikane druhet ti qaset problemeve të

Ballkanit në mënyrë tërësore dhe reale dhe ballore. Cila është arsyeja? Ka shumë, por do të përmendim vetëm një: Megjithse kanë kaluar 16 vjet nga përmbyjsja e socializmit, mjaft politikanë euroamerikanë vazhdojnë të sillen në marrdhëniet me ish-vendet socialiste dhe politikanët e këtyre vendeve me mentalitetin e fitimtarit dhe humbësit dhe jo me mentalitetin e të barabartëve. Një sjellje e tillë reflekton në disa raste një lloj arrogance në diskutimin dhe debatin për probleme të ndryshme që ekzistojnë në Ballkan dhe vende të ndryshme të tij. Prandaj edhe në themel të mjaft politikave të imponuara dhe artificiale qëndron ky mentalitet. Dhe mentaliteti i fitimtarit e ka të vështirë të pranojë gabimin, ndërsa e ka të pamundur të pranojë dështimin. Prandaj imponon edhe kur e sheh që imponimi do të lindë destabilizim apo tensione të ndryshme. Ndërsa klasat politike të këtyre vendeve në shumicë reagojnë me vështirësi ose nuk reagojnë fare edhe kur shfaqet hapur politika imponuese mbi rrugët e zgjidhjes së problemeve të vendit apo vendeve të tyre.

Më hapur ky imponim dhe artificialitet shfaqet në zgjidhjen e problemeve të shqiptarëve. Politika euroamerikane e pranon se rrethimi i Shqipërisë aktuale nga troje dhe popullsi shqiptare përbën absurdin më të madh në Europë. E megjithëkëtë, askush prej tyre nuk pranon ta zgjidhë këtë absurd politik, i cili nuk është asgjë tjetër veçse rezultat i politikave të tyre të së kaluarës. Dhe ky problem zgjidhet vetëm duke u trajtuar ai në mënyrë tërësore. Dhe tërësore do të thotë se nëqoftëse dikur kemi pasur një pjestim për pesë, zgjidhje do të thotë që tashmë të kemi një shumëzim për pesë. Pjestimi për pesë solli artificialitetin. Solli një Shqipëri Artificiale dhe copa të tjera Shqipërie të shpërndara në shtete të ndryshme. Nderkaq shumëzimi për pesë do të sjellë krijimin e Shqipërisë natyrale. Por jo vetëm kaq. Do të sjellë edhe natyralitetin në shtete të ndryshme të Ballkanit si

Serbia, Mal i Zi, Maqedonia.

Strategjia e eksportimit të krizave dhe «Shqipëria natyrale»

Ka një dukuri interesante në rajonin e Ballkanit. Ajo ka të bëjë me krijimin e realiteteve iluzive duke eksportuar krizat atje ku nuk janë. Kështu krijohet një realitet iluziv. Dhe ky realitet gjen terren në hapsirën shqiptare e cila vazhdon të shërbejë si «rrufepritëse» e të tjerëve dhe e problemeve të tyre.

Po parashtroj dy probleme për të ilustruar çka u tha më lart :

Problemi i parë i pazgjidhur përfundimisht i Ballkanit është Serbia

Serbia është një shtet që doli më vehte pas shpërbërjes së Jugosllavisë, por që ka akoma

probleme që kanë të bëjnë me identitetin e saj politik.

E para : Serbia është akoma shteti që vetquhet demokratik, por që dhe ka si forcë të parë politike parlamentare një parti ultra nacionaliste e cila përbën një të tretën e parlamentit të Serbisë. Ajo quhet Partia Radikale Serbe e drejtuar nga Tomisllav Nikoliç. Në asnjë vend tjetër të rajonit nuk e gjen këtë mozaik politik.

E dyta : Serbia ka akoma një rajon të tërë të quajtur Sanxhak ku popullsia boshnjake ka akoma probleme etnike të mprehta me qeverinë e Serbisë.

E treta : Serbia ka akoma probleme etnike të pazgjidhura në Vojvodinë ku grindjet, racizmi dhe konfliktet me popullsinë hungareze tashmë janë bërë edhe problem europian.

E katërta : Serbia ka shumë më pak probleme me popullsinë shqiptare në Luginën e Preshevës veçanërisht pas përmbysjes së Milosheviçit. Popullsia shqiptare në këtë rajon është në prag të lidhjeve vertikale me Tiranën.

E pesta : Serbia ka akoma probleme me Republikën serbe të Bosnjës të cilët mbi bazën e natyralitetit kanë të drejtë të kërkojnë bashkim me Serbinë. Megjithatë Serbia dhe politika e saj përpiqet ti shkarkojë problemet e saj tek rrufepritësi Kosovë.

Problemi i dytë i pazgjidhur përfundimisht është Maqedonia.

Edhe Maqedonia është një shtet që lindi pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Pas më shumë se një dekade si shtet më vehte, Maqedonia ka akoma probleme me fqinjët e saj duke u shndërruar kësajsoji në një ndër problemet kryesore në rajon. Maqedonia ka akoma probleme me fqinjin e saj ballkanik Greqinë e cila nuk i njeh emrin. Ka akoma probleme me fqinjin e saj po ballkanik Bullgarinë që nuk i njeh etninë. Ashtu siç ka probleme me fqinjin e saj verior Kosovën që nuk i njeh kufirin. Nuk ka asnjë problem me Shqipërinë e cila ja njeh të gjitha. Megjithëse Maqedonia ka brenda kufirit të saj shtetëror mijra kilometra katrorë toka shqiptare dhe mbi 650 mijë shqiptarë autoktone. Maqedonia vazhdon të jetë akoma pa emër të regjistruar në «gjendjen civile politike» të quajtur OKB.

Maqedonia megjithëse është me Marrëveshje të Ohrit është akoma pa mentalitetin e kësaj Marrëveshje. Në 7 nëntor 2004, më shumë se 409 mijë qytetarë të Maqedonisë votuan legalisht kundër kësaj Marrëveshje. Aso kohe ultranacionalizmi maqedonas kaloi deri në absurd në qytetin e Strugës. Të drejtuar nga një këngëtar i quajtur Romeo Dareban, ata shpallën pavarësinë e Strugës duke kërcënuar se do të shkëputen nga Maqedonia nëqoftëse do të miratohej ndarja e re territoriale e Maqedonisë. Shqiptarët janë të lidhur artificialisht me shtetin e Maqedonisë. Këtë artificialitet ata padashur e forcuan në luftën e vitit 2001, kur në deklaratimet e tyre shpreheshin qysh në krye të deklaratave se do të mbeten «roje të Maqedonisë».

Megjithë këtë tërësi problemesh, Maqedonia dhe partitë politike maqedonase përpiqen dhe në shumicën e rasteve ja dalin që problemet e tyre ti fshehin duke eksportuar krizën në mjedise politike, ekonomike dhe sociale shqiptare.

Kombi që bën të tjerët, pa bërë vetvehten

Përmendja dhe analiza e problemeve të mësipërme nuk është rastësore apo për efekte historizmi? Ka një arsye tjetër. Duhet të bëhen më të prekshme dy tabllotë që ekzistojnë në rajon. Tablloja reale dhe ajo virtuale. Problemet reale më shumë ekzistojnë tek të tjerët. Ndërsa në mënyrë virtuale ato eksportohen në hapsirën shqiptare.

Çfarë janë sot shqiptarët? Janë kombi që më shumë ndihmon të tjerët të bëhen, pa bërë akoma vehten e tyre. Shembujt e mëposhtëm janë të mjaftueshëm për të na bindur në pohimin e mësipërm.

Ka afër një vit që diskutohet për statusin e Kosovës. Por ka gati një vit që diskutohet konkretisht për liritë dhe të drejtat e pakicës serbe në Kosovë. Pra ata që nuk janë bërë vetë, përpiqen dhe mbajnë përgjegjësi përse nuk kanë bërë të tjerët!!

U trajtua si sukses i madh fakti që vota e shqiptarëve bëri shtet të pavarur Malin e Zi. Me votat e shqiptarëve, Mali i Zi arriti përqindjen prej 55.5 dhe shpalli pavarësinë. Megjithatë ata janë të pa bërë vetë, megjithatë ata nuk marrin dot asnjë komunë siç është Tuzi, ata garantuan pavarësinë e një shteti të një kombi tjetër. Si sukses i madh u trumbetua edhe fakti që

luftëtarët shqiptarë garantuan integritetin e Maqedonisë. Ali Ahmeti dhe luftëtarët e tjerë të UÇK, nuk kishin të drejta për vehte, ata ishin të paamnistuar e përsëri nuk mungonin së thëni se për ata Maqedonia është atdheu i tyre.

Tablloja e mësipërme është e shkurtër, por mjafton. Mjafton edhe për politikën edhe për qytetarët shqiptarë, por edhe për miqtë dhe aleatët e huaj. Ashtu siç mjafton edhe për vetë fqinjët e shqiptarëve. Mjafton për të

rithënë se nuk përngjet me asnjë traktat demokracie, me asnjë traktat lirish dhe të drejtash njerëzore, pohimi se kombi që bën të tjerët, akoma nuk është bërë vetë. Prandaj se edhe pohimi tjetër që Shqipëria Natyrale është nocion europeist dhe progresist duhet të mos mbetet i tillë përgjatë viteve 2006-2013.

Integrimi në Bruksel dhe integrimi në Tiranë

Edhe nëntitulli i sipërthënë një objekt i analizës. Shqiptarët ndodhen sot përballë dy integrimesh. Janë integrimet ndërshqiptare, por janë edhe integrimet europiane. Një mendësi u thotë që të shtyjnë edhe për disa dekada integrimet ndërshqiptare, për hir të integrimëve europiane. Është një mendësi që përkon edhe me pohimet e një pjese të politikës europiane e cila jo rrallë herë kujtohet të pohojë se është më mirë të takoheni dhe bashkoheni në Europën e Madhe dhe jo në Shqipërinë Natyrale. Por nga ana tjetër shqiptarët janë para një dileme të madhe. Ata sot janë ndoshta populli më i izoluar i Europës. Ndërkaq integrimi i tyre duket se është shtyrë gjatë. Presidenti i Komisionit Europian Barroso pas pranimit të Rumanisë dhe Bullgarisë u shpreh hapur se duhet të ndërpritet zgjerimi i BE

deri sa të rregullohet çështja e Kushtetutës. Pavarësisht propagandës, duket se integrimet

europiane shqiptarët dhe disa fqinjë të tyre do ti shijojnë të fundit. Përballë tabllësë reale dhe jashtë propagandës virtuale, shqiptarët ndeshen me një mendësi tjetër e cila merr përparësi në pritje të integrimeve europiane. Atyre u duhen integrimet ndërshqiptare. (Jo pushimet në Ulqin dhe në Durrës që disa i konsiderojnë integrimet. Sepse me këto mend, do të na dalë që shqiptarët synojnë të integrohen në fillim me Stambollin, pasi pushimet më të shumta i bëjnë në bregdetin turk). Prandaj integrimet ndërshqiptare me qendër Tiranën duket se do të jenë më të shpejta se integrimet me qendër Brukselin. Pohimi i sapothënë nuk është nacionalizëm. Brukseli është një aspiratë ndërsa Tirana duket se do të jetë një realitet. Të vazhdosh të ankoesh, përsë nuk po integroesh ne Bruksel, kjo është politikë dhe mentalitet qaramani. Ndërsa të realizosh me ndihmën dhe në partneritet me Brukselin dhe Uashingtonin, integrimet ndërshqiptare; ky qëndrim është partneritet euroatlantik. Është europeizëm dhe progres. Prandaj edhe duhet përkrahur, duhet inkurajuar, debatuar për rrugët më të shpejta, më efektive.

Shqipëria Natyrale është europeizëm, nuk është një aventurë

Shqipëria Natyrale nuk është një aventurë, ajo është europeizëm i kulluar. Po përse është e tillë. Është e tillë, sepse Shqipëria natyrale nuk ngrihet mbi artificialitete, nuk ngrihet mbi mite dhe legjenda, nuk ngrihet mbi të tjerët dhe në kurriz të të tjerëve. Ajo duhet të ngrihet atje ku ka shqiptarë dhe jo atje ku ka këngë për shqiptarë apo mite për shqiptarë. Ajo mëton të sendertohet jo mbi histori të mesme apo të lashtë, por mbi realitetin e sotëm. Ajo e njeh historinë, por pranon dhe realitetin edhe kur ai është i dhimbshëm. Prandaj ajo u thotë edhe fqinjëve të saj që edhe ju mos u ngrini mbi kurrizin e shqiptarëve, por mbi kurrizin tuaj. Shqipëria Natyrale nuk merret me Mollën e Kuqe, as me Pargën, as me Kosanicën dhe Toplicën. Por ajo është e detyruar të merret me Mitrovicën, me Preshevën, me Ulqinin, me Strugën, etj etj. Njohja e realitetit sjell edhe zgjidhjet e tij, sjell edhe stabilizimin e tij. Fshehja e këtij realiteti, sjell edhe traumat, destabilizimin, dhunën dhe konfliktet.

Njohja e realitetit ka brenda edhe dhimbjen e së vërtetës. Tashmë kjo e vërtetë ka dalë sheshit. Kufijtë e Shqiperisë me shtete të tjera të Ballkanit nuk janë natyralë, janë artificialë. Ashtu si edhe teritoret e disa shteteve fqinjë nuk janë plotësisht natyralë, por kanë edhe artificialitet brenda tyre. Dhe ky artificialitet shfaqet hapur kur disa nga këto shtete kanë teritore dhe popull shqiptar brenda tyre. Fshehja e këtij realiteti ka brenda dhimbjen e mashtrimit. Ky mashtrim zgjati afër një shekull. Nuk mund të zgjasë më, sepse edhe atë e kanë kuptuar të gjithë. Por dhimbja e së Vërtetës është shumë herë më e lehtë se Dhimbja e mashtrimit. Shqipëria Natyrale është pjesë përbërëse e dhimbjes të së vërtetës, prandaj ka edhe të ardhme. Shqipëria Artificiale është pjesë e dhimbjes së mashtrimit, prandaj edhe nuk do të ketë të ardhme.

.....Asnjëherë nuk është vonë për të ndrequr gabimet

Pavarsisht ngarkesave fillestare ndaj këtij nocionit Shqipëri natyrale, ai tashmë ka filluar

të trokasë fort në portat e vitit 2013, që është 100 vjetori i Shqipërisë Aktuale. (Referenca ndaj vitit 1913 nuk ka të bëjë me ditën e shpalljes së pavarësisë, por me njohjen e saj nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër në fillim të vitit 1913). Piniot e përmendi Shqipërinë natyrale si nocion në Parlamentin Europian në fundvitin 2006. Është përgjegjësia historike dhe përgjegjshmëria qytetare për politikën dhe opinionin publik shqiptar që në vitin 2014, Shqipëria Natyrale në Parlamentin Europian nuk duhet të jetë vetëm një nocion politik. Por një realitet politik, gjeografik, gjeopolitik ekonomik, social etj.

Por duhet menduar qysh tani se si duhet arritur. Dikush mund të thotë se duhen edhe 7 vjet që të mbushen 100 vjet, prandaj kemi kohë. Por kur mendon se sa probleme të pazgjdhura kemi akoma përpara, atëherë 7 vjet janë pak për të sendertuar Shqipërinë Natyrale. Për shembull : Një problem madhor është se shqiptarët kanë 93 vjet që shkruajnë dhe flasin se shpallja e pavarësisë së Shqipërisë Aktuale, ishte edhe tragjike, pasi la jashtë shtetit, gati gjysmën e hapsirave dhe popullit shqiptar. Qytetarë, shtetarë, gazetarë, historianë, politikanë përgjatë këtyre 93 vjetëve kanë pohuar pohimin e sipërthënë. Por edhe politikanë, qeveritarë apo gazetarë të huaj kanë qenë dakord me anën tragjike të krijimit të shtetit shqiptar. Pra kanë pranuar se veç haxhiqamilëve shqiptarë që ishin injorantë, kanë pasur edhe atahaxhiqamilët e tyre që nuk ishin injorantë. Haxhiqamilizimi nuk barazohet vetëm me injorancën. (Nuk është haxhiqamilizëm të kërkosh vetëm «babën», por është haxhiqamilizëm edhe kur të ndajnë nga Nëna dhe të japin me zor Vojvodën për «Burrë»).

5 pyetje-analizë që shqiptarët duhet t'ju japin përgjigje:

Pyetja e parë: Shtetarët dhe qeveritarët, qytetarët dhe historianët e Tiranës Politike, përgjatë këtyre 7 vjetëve deri në vitin 2013 do të vazhdojnë të flasin edhe për tragjizmin e krijimit të shtetit shqiptar? Por vetëm do ta konstatojnë këtë tragjizëm apo do kërkojnë eliminimin e tij? Por nëqoftesë do ta kërkojnë këtë eliminim, në çfarë forme do ta bëjnë atë. Do vajojnë apo do të argumentojnë?

Pyetja e dytë: Shtetarët dhe qeveritarët, qytetarët dhe historianët e Prishtinës Politike, përgjatë këtyre 7 vjetëve deri në vitin 2013 do të njohohen vetëm me kushtëzimin e shtetit apo do ta çojnë mendimin e tyre politik më tutje deri tek Shqipëria Natyrale. Shqiptarët jashtë Kosovës mendojnë për pavarësinë e saj, ndërsa shqiptarët e Kosovës duhet të mendojnë më shumë se pavarësia, ata duhet të mendojnë Shqipërinë Natyrale.

Pyetja e tretë: Qeveritarët, politikanët, qytetarët apo mendimtarët shqiptarë në Maqedoni, përgjatë 7 vjetëve, si do ta presin vitin 2013? Duke thënë se nuk kemi çfarë të bëjmë. Sepse ne jemi për stabilitet apo duke thënë se artificializmi në ndërtimin e shteteve është destabilizuesi më i madh jo vetëm i atij shteti, por edhe i gjithë rajonit. Do të thonë se e konsiderojnë Maqedoninë si atdheun e tyre, sepse kanë varret e të parëve të tyre? (Po ata që kanë varret e të parëve të tyre në Turqi, Greqi, Itali, SHBA etj si duhet ti konsiderojnë këto shtete, si atdheun e të parëve të tyre?. A do të vazhdojnë ata të mbushin boshllëkun e krijuar nga Maqedonia e Pirinit apo e Egeut, për të jetuar artificialisht Maqedonia e

Vardarit, apo do të kërkojnë me të drejtë, zëvendësimin e artificialitetit me natyralizmin.

Pyetja e katërt : Politikanët dhe historianët, qytetarët dhe gazetarët e Luginës së Preshevës, përgjatë 7 vjetëve, çfarë përgatitjesh do të bëjnë për të festuar 100 vjetorin e shtetit shqiptar? Do të mjaftohen vetëm me ngritjen e flamurit kombëtar, do të vajtojnë fatin e keq që i ndau nga Trungu i Shtetit-Amë, apo do të veprojnë ndryshe. Por ndryshe qysh tani dhe vetëm me dialog dhe me mjete demokratike. Për shembull: duke kërkuar qyshtani vendosjen e lidhjeve vertikale midis Preshevës dhe Tiranës, Preshevës dhe Prishtinës etj etj.

Pyetja e pestë: A do të pranojnë politikanët shqiptarë të Ulqinit, Tuzit, Plavës apo Gucisë që viti 2013 është 100 vjetori sa historik aq edhe tragjik i shtetit shqiptar. Apo do të ngushëllohen me idenë se midis Malit të Zi dhe Shqipërisë nuk ka viza. Dhe se atje ku nuk ka viza nuk ka as Atdhe? Apo do të ecin me idenë tjetër se çdo verë në Ulqin shkojnë të pushojnë me mijra shqiptarë nga Kosova dhe Shqipëria? Është një paraqitje e shkurtër e pyetjeve-analizë. Por mjaftojnë.

Pyetjet-analizë të parashtruara më lart synojnë më shumë diskutimin dhe analizën e një problemi për politikën dhe mendimin politik shqiptar të hapur nga vetë zhvillimet rajonale dhe gjeopolitika e tyre. Dështimi i Marrëveshjeve artificiale mbi bazën e të cilave u ngritën shtetet e Ballkanit u jep të drejtën historike, morale dhe bashkëkohore shqiptarëve të kërkojnë partneritet me fqinjët dhe aleatët e tyre. Politika shqiptare duhet të pushojë së qeni porosimarrëse, duke u shndërruar dora dorës në këshilluese dhe pse jo edhe parashikuese e proceseve politike dhe gjeopolitike në rajon dhe më gjerë. Për shembull : Sa kohë që është përmbysur marrëveshja artificiale dhe imponuese e Versajës e vitit 1919 e cila krijoi shtetin artificial Jugosllavi, aq kohë problemi nuk mund të mbyllet artificialisht. Që do të thotë se Mali i Zi që tashmë fitoi pavarsinë, pasi vitin 1919 u dhunua me marrje pavarësie. Mbi këtë bazë Drejtësia e Vonuar nuk duhet të veprojë me dy Kute, një për Malin e Zi dhe një për shqiptarët. Përndryshe do të ishte Drejtësi e Cunguar. Duke përshëndetur rikthimin e drejtësisë tek Mali i Zi, politika dhe opinioni shqiptar duhet të prezantojë edhe dhunimin e Shqipërisë në Konferencën e Versajës. Duke pozuar dhunimin, natyrshëm duhet të kërkohet rikthimi i dinjitetit, që në rastin konkret do të thotë rikthimi i trojeve shqiptare si Kosova, Lugina e Preshevës, Pollogu, Ulqini etj etj.

Sa shtetarë duhen për Shqipërinë natyrale?

Natyrisht që shumëkush mendon për Vitin 2013. Natyrisht që shumëkush ka të drejtën e tij për të dhënë mendimin se si duhet ta festojmë 100 vjetorin e shtetit të sotëm shqiptar. Për shembull: Ka midis politikanëve të të gjithë hapsirës shqiptare, disa që thonë se është më mirë që të kemi 2 presidentë, 2 kryeministra, 3 zëvendëskryeministra, 36 ministra, 72 zëvendësministra etj etj se sa të kemi vetëm 1 president, 1 kryeministër dhe 13 ministra. Duke marrë parasysh faktin se këtë mendim e kanë një numur politikanësh, duhet të marrësh parasysh se ata do të jenë edhe kundërshtarë të sendertimit të Shqipërisë Natyrale (Kështu do të ketë ndodhur edhe

atëhere kur pas vdekjes së Skënderbeut për mëse dy shekuj, shqiptarët mbetën pa histori. Duket se Turqia duke njohur këtë mentalitet preferoi të kishte me dhjetra gjeneralë, zadriazemë, pashallarë shqiptarë të shpërndarë në të gjithë Perandorinë se sa një zadriazem dhe disa gjeneralë vetëm për Shqipërinë.)

Por gjithsesi do të jetë një pengesë e vogël. Kanë ndryshuar rrethanat, koha etj. Megjithatë, Shqipëria Natyrale hyri si nocion politik. Tashmë ajo duhet të sendërtohet si realitet nga shqiptarët në bashkëpunim me fqinjët dhe me aleatët ndërkombëtarë. Shtatë vjet mjaftojnë të argumentojmë se shtetet artificiale kanë qënë burime dhe pretekste konfliktesh dhe luftrash. Ndërsa shtetet natyrale kanë qënë dhe janë burime stabiliteti dhe progresi. Prandaj Shqipëria Natyrale është një nocion europërendimor dhe duhet përkrahur për tu realizuar.

Dialog me këdo, dialog për gjithshka

Nëntitulli i sythit ka të bëjë me përjashtimin e dhunës për formimin e Shqipërisë Natyrale. Nëntitulli synon dy drjtime të rëndësishme.

Drejtim i parë ka të bëjë me vetë shqiptarët si qytetarë dhe si politikanë. Sa kohë jetojmë në një rajon që po bëhet përherë e më shumë demokratik, aq kohë edhe problemet etnike duhet dhe do të zgjidhen me mjete demokratike. Dialog me këdo, dialog për gjithshka, qoftë edhe duke mos vendosur asgjë ne fillim; është thelbi i veprimtarisë për jetësimin e Shqipërisë Natyrale. E rëndësishme është të hapet problemi, të mësohet politika dhe opinioni publik me ekzistencën e problemit dhe nevojën e zgjidhjes së tij. Bashkësia ndërkombëtare në zgjidhjen e statusit të Kosovës na pausi me një përvojë të madhe. Cila është ajo përvojë që na duhet ta përdorim edhe në rastin e Shqipërisë natyrale? Përgjatë një viti, kjo bashkësi i mësoi veshët politikë të sërbeve me fjalën pavarasi apo pavarasi e kushtëzuar, ndërsa veshët e shqiptarëve me decentralizim, me krijime komunash. Por veprimi pak nga pak dhe sot është me lehtë për të prerë shiritin. Le ta përvehtësojmë këtë mësim të madh edhe ne rastin e Shqipërisë Natyrale. Kemi 7 vjet kohë. Le të fillojmë me argumente, me dialog pak nga pak. Le të mos i ngatërrojmë qeveritë në fillim. Le të pranojmë se ne jemi bashkohës realë te Europës, pa qënë bashkëkohës historikë të saj. Dhe të kërkojmë të jesh edhe bashkëkohës historik me dialog dhe mjete demokratike, ky është progres dhe si i tillë ai përshëndetet.

Fragmente jete nga Shqipëria e pjestuar për pesë

Sa larg është Shengeni nga Berlina???

Është akoma i freskët në memorien historike por edhe aktuale përmbajtja politike e atij që quhej Muri i Berlinit. I ndërtuar mes për mes një qyteti ai mori një kuptim simbolik,

ndarjen e Europës në dy botë, në dy sisteme. Muri simbolizonte mungesën e qarkullimit të lirë të njerëzve nga njëra pjesë në pjesën tjetër të kontinentit. Jo më kot rrëzimi i këtij muri në fundvitin

1989 u përjetua jo thjesht si rrëzimi i një muri, por si rrëzimi i gjithë atyre barrierave që e pengonin këtë qarkullim të lirë.

Por 13 vjet pas rrëzimit të Murit të Berlinit qytetarët e Shqipërisë, janë duke parë se si rreth kufijve të tyre tokësore apo detarë, Muri i Berlinit është zëvendësuar nga nje Mur tjetër. Ai quhet Muri i Shengenit . Ndërsa kufijtë janë zëvendësuar nga kufizimet.

I pari ishte Muri i sistemeve të kundërta politike dhe ideologjike, i dyti është muri brënda të njëjtit sistem dhe të së njëjtës ideologji.

I pari ishte hapur kërcënues, gati një Sfinks i lirive dhe të drejtave të njerezve. I dyti është i kamufluar me plotësim kushtesh dhe standartesh të llojllojshme, shpesh herë vrastare.

I pari ishte midis dy botëve, i dyti është përbrënda një bote. I pari ishte muri i ndarësise, i dyti muri i ndërvarësise.

Ata që donin të kalonin Murin e Berlinit nje pjesë vriteshin në emër të ruajtjes së atdheut. Ndërsa qytetarët që duan të kalojnë Murin e Shengenit vriten në mjaft raste nga antarët e Murit ne emër të luftës kundër trafiqeve. Natyrisht nuk vriten as trafikantët dhe as kontrabandistët.

Muri i Berlinit as që kishte ndonje nen për integrimin, ndërsa Muri i Shengenit duke patur në thelb integrimin, presupozon edhe kufizimin. I pari fillonte në Berlin dhe mbaronte diku në Siberi. I dyti kufijtë i ka me te vegjël. Muri i Shengenit fillon diku në Subotice, kalon nga gjiri i Kotorrit, shtrihet në Otranto, prek Kakavijen, ngjitet lart në Gjevgjeli, ndalon ne Gjushevo dhe përfundon ne Nish.

Ky mur megjithatë ka disa kalime të pjesshme, gati gati si frëngjitë e kullave të Veriut. Nëpër këto kalime lejohet të kalojë vetëm elita e shteteve që ndodhen jashtë Murit. Ky kalim përmbledhet në togfjalëshin "pasaportë diplomatike apo pasaportë shërbimi". Ndërsa masat milionëshe shqiptare sërbe, boshnjake, maqedonase etj duhet të marrin lejen që nuk ua japin të kalojnë Murin. Prandaj mijra syresh përpiqen ta kalojnë ilegalisht. Natyrisht sic e pamë edhe herën e fundit në Karaburun, nuk ka më kufitarë si dikur që ose të kapin ose të vrasin teksa përpiqesh të kapërcesh murin me përjashtim të Greqisë, kufitarët e së cilës edhe të vrasin. Por ka kthim mprapa, ka konventa me vendet përkatëse për të ripranuar ata që kanë kapërxyer ilegalisht Murin, ka viza fallco. Ka edhe mbyetje në det që quhen

tragjedi. Natyrisht tashmë ka ndryshuar edhe emërtimi i kapërximit ilegal te Murit. Nuk quhet me Tradhëti ndaj Atdheut, por quhet Klandestinitet, Ilegalitet në Europën e Bashkuar, nga antarë të vetë Europës gjeografike !!

Natyrisht tani ka ndryshuar edhe një gjë tjetër madhore. Para rënies së Murit të Berlinit, të gjithë ata që arrinin ta kapërcenin këtë mur, priteshin me nderime në Bruksel. Ata shërbenin si propagandë për të demaskuar shtetet nga vinin që nuk lejonin lirinë dhe

qarkullimin e lirë.

Ndërsa tani, që jemi bërë një, tani që Shqipëria dhe klasa e saj politike e lejon qarkullimin e lirë, tani kanë ndryshuar ATA në Bruksel. Tashmë qytetarët që duan të kapërcejnë Murin e Shengenit, priten me përbuzje nga Brukseli, quhen klandestinë, trafikantë, kontrabandistë, rikthehen prapa, ndodh edhe nganjeherë që "gabimisht", përplasen me ndonjë anije ushtarake sic bëri Sibila dhe bëhen pre i peshqeve në fund të detit. Nderimet ishin rezervuar vetëm për kaluesit e Murit të Berlinit. Përbuzja është rezervuar për kaluesit e Murit të Shengenit. Dy qytete, nje mur, dy qëndrime!

Eshtë gati një situat paradoksale! Nga njëra anë ATA që kanë ndërtuar Murin e Shengenit në Bruksel e justifikojnë nevojën e ekzistencës së tij, me paaftësinë e elitës politike të Shqipërisë. Ndërsa nga ana tjetër, po me vendime të posacme, të gjitha vëndet që kanë kontribuar për ngritjen e Murit të Shengenit, e lejojnë elitën politike të Shqipërisë që vetëm ajo ta kalojë legalisht Murin. Ndërsa qytetarët e thjeshtë e kanë të ndaluar. Nje lukuni politikanësh dhe diplomatësh që në vëndet e tyre kanë ngritur Murin e Shengenit, priten gati me përulësi dhe servilizëm kur vine ne Shqipëri. Ata lëshojnë disa fjalë të mira dhe ikin duke lënë pas hijen e Murit të frikshëm. ATA që vijnë në Tiranë dhe japin leksione demokracie, teksa kthehen ne vëndet e tyre, miratojne ligje antidemokracie për qytetarët shqiptarë që janë jashtë Murit. Atëhere; cili është thelbi i leksioneve të tyre ? Demokraci selektive ; ky është emërtimi më i saktë i leksioneve. Kjo lloj demokracie, e pathënë, por e zbatuar shtrihet mbi Shqiperinë dhe mbi qytetarët shqiptarë.

Dhe paradoksi bëhet më i madh kur lexon Robert Badinterin, konstitucionalistin e shquar francez që propozon se Kryeministër i Europës së Bashkuar duhet të jetë ose Toni Bler ose Hoze Maria Aznar, që President Moral i Europës së Bashkuar duhet të jetë ose Zhak Delor ose Mario Soares ose Bronisllav Geremek.

Po ne që jemi jashtë murit, përtej Ures së Qabesë, në bregun e prag vdekjes sic thoshte Kadareja, a duhet të votojmë zoti Badinter ??! 45 vjet zgjati pritja e rënies së Murit te Berlinit. Sa do zgjasë vallë rënia e Murit të Shengenit per shqiptarët.?

Muri i Berlinit ! Muri i Shengenit. Dhe Parlamenti i Shqipërisë mbaroi Seancen e Jashtëzakonshme kushtuar disa dhjetra qytetarëve që nuk kaluan dot Murin e Shengenit por mbetën përtej Urës së Qabesë. Dilemë e Madhe për Nizamët e Europës Moderne. Dhe në pritje të zyrtarëve të PërtejMurit apo të ndonjë Seance tjetër parlamenti, le të këndojmë vargjet e Bagrickit : Gëlltite ti varkën; o det musliman! 19 Janar 2004

NXIJENI AKOMA SE NUK ESHTË NXIRË MIRË!!

Objekti i Analizës

Asnjë forcë politike nuk mbrohet dhe nuk kritikohet. Asnjë politikan apo qeveritar gjithashtu. Objekti është diçka tjetër më e madhe sesa një qeveri apo një forcë politike në pozitë apo opozitë. Objekti është vendi në të cilin jetojmë dhe i cili na ka dhënë përkatësinë kombëtare. Me forma dhe mënyra nga më të ndryshmet ai po nxihet përditë e më shumë.

Hyrje në Analizë.

Duhet të jenë bërë mbi 7 raporte të institucioneve ndërkombëtare brenda një muaji, ku është edhe emri i Shqipërisë. Që nga Departamenti i Shtetit, Bashkimi Europian për të përfunduar me një organizëm që edhe emri i jepet anglisht, "Freedom House". Në të gjitha këto raporte përkrah emrit Shqipëri, ka korrupsion në nivelet më të larta, trafik droge me ton dhe jo me kuintal, trafik organesh njerëzore dhe klinika të specializuara për këtë çështje, nepotizëm klientelizëm, pafuqi ligji. Nxijeni akoma se nuk është nxirë mirë. Dhe Bashkimi Europian vendos të dërgojë në Shqipëri ekspertë të drogës.

Analizë

Dikush mund të thotë se çfarë të keqe ka, ata janë miqtë tanë dhe na duan të mirën, pastaj ata e kanë me qeverinë dhe jo me Shqipërinë. Dikushi apo edhe shumëkushi kanë të drejtë. Por edhe unë të drejtë kam. Sepse në të gjitha listat dhe raportet që kam parë në fillim thuhet: Shqipëria. Pastaj vijnë të gjitha të zezat. Dhe në asnjë raport nuk thuhet Qeveria. Pra raportet tregojnë vendin dhe jo formën e organizimit politik të vendit. Dhe vendi është Shqipëria dhe jo qeveria. Qeveria është e Shqipërisë dhe qytetarëve të Shqipërisë. Epo mund të thotë dikush apo shumëkush se këto nuk janë nxirje, por bëhen për të mirën e popullit shqiptar sepse akuzohet qeveria. Pra bëhen për integrimin e Shqipërisë. Por dikushit apo shumëkushit dua t'i them se mua nuk më intereson fare qeveria dhe qeveritarët. Më intereson identiteti im si qytetar i këtij vendi së bashku me vlerat e tij. Në romanin e saj « Një martesë pa rëndësi », shkrimtarja e shquar zvicerane Liliane Perrin në gojën e personazhit kryesor që është shqiptar evidenton këtë shprehje : «Je suis pauvre, mais j'ai mon histoire» (Unë jam i Varfër, por unë kam historinë time). Dhe kur ti brenda një muaji ma nxin me 7 raporte dhe vazhdon të thuash: Nxijeni akoma se nuk e keni nxirë mirë; unë kam të drejtë të mendoj: Përse më duhet mua ky lloj integrimi ? Po pse nuk ishte ish-ambasadori amerikan Xhefri që ishte bërë si bashkëkryeministër me Nanon. Nuk është ambasadori italian Januçi që ngjan më shumë me një zëvendëskryeministër sesa me një ambasador? Atëherë po të ishte ndryshe se gjoja raportet e kanë me qeverinë dhe jo me Shqipërinë, ata do të hiqnin qeverinë dhe do të ruanin Shqipërinë. Por përsëri e ke gabim mund të më thotë dikushi apo shumëkushi. Sepse ata nuk mund të ndërhyjnë sepse ne jemi vend Sovran. Si sovran ? Ku është sovraniteti ynë dhe për çfarë sovraniteti flitet? Sepse sovraniteti qoftë në një botë të integruar apo qoftë në një botë të ndërvarur nuk është njësoj me sovranitetin në një botë siç ishte bota bipolare. Pse në emër të sovranitetit i thirrëm ne forcat shumëkombëshe në vitin 1997?

Por bolla me dialog. Qeveritë në Shqipëri do venë dhe do vijnë. Ja do ikë dhe kjo qeveri. Po pastaj? A do të shkuajë më "Freedom House" siç shkruan tani për Shqipërinë. Sa emër i bukur: "Shtëpia e Lirisë" por që nxin Shqipërinë!!

Nxijeni akoma se nuk është nxirë mirë!!

Shikoni logjikën e Komisionit Europian lidhur me liberalizimin e vizave me Shqipërinë: « Nuk e bëjmë dot sepse ju nuk luftoni siç duhet disa gjëra si korrupsioni apo drogën etj ». Nuk ka cinizëm më të madh. Pse? Po pranojmë për një çast se nga Shqipëria kalojnë dhjetëra ton drogë siç thotë raporti. Pyetje numër një? Nga vjen kjo drogë dhe nga kalon që hyn në Shqipëri ? Pyetje numër dy: Ku shkojnë këto dhjetëra ton drogë që na vijnë nga Shqipëria ? Vjen nga vende që janë ose anëtare të Bashkimit Europian ose kandidatë për t'u pranuar në BE dhe shkon në vende që janë të gjithë anëtarë të Bashkimit Europian. Shqipëria është një vend tranzit. Pyetje numër tre: Përse këto vende janë ose anëtare të BE-së ose aspirante siç i thoni ju, përse qytetarët e tyre qarkullojnë lirshëm nëpër Europë. Pra dy lloj kutesh vlerësimi. Ju që konsumoni me dhjetëra ton drogë në Itali, Gjermani, Angli, Belgjike etj. keni të drejtë të qarkulloni ku të doni. Ju që sillni nga Bullgaria, Rumania, Maqedonia me dhjetëra ton drogë në Shqipëri përsëri keni të drejtë të qarkulloni. Ndërsa vetëm «Hamallët e Drogës», nuk kanë të drejtë thotë Komisioni Europian? Atëherë paskemi të bëjmë me Demokraci Selektive të Bashkimit Europian ndaj qytetarëve të Shqipërisë.

Mosliberalizimi i vizave për qytetarët e Shqipërisë nuk është problem droge apo korrupsioni, as problem qeverisjeje, as problem kulture, as problem arsimit. Është më tepër. Është problem fobie, është problem i mentalitetit të atyre që kanë në dorë liberalizimin e vizave. Ndoshta lidhet me faktin se shqiptarët nuk janë as popull gjermanik, as popull sllav dhe as latin, pra ata nuk kanë «kushërinj politikë». Ndoshta se shqiptarët kanë bërë pjesë në të kaluarën e largët jo për fajin e tyre në Perandorinë Otomane dhe jo në Perandorinë Austro -Hungareze. Ndoshta se ata nuk kanë përdorur dhe nuk përdorin Demokracinë Selektive ndaj minoriteteve. Megjithatë problemi mbetet: Qytetarët e Shqipërisë vazhdojnë të jenë klandestinë brenda Europës. Dikush apo shumëkush mund të më thotë se po mbron qeverisjen dhe qeverinë e Nanos. Por nuk ka apo nuk kanë të drejtë. Në trajtesën që po bëj dhe mendimet që po shfaq Nano, Berisha, Meta, Topi, Dokle, Pellumbi, Moisiu janë vetëm qytetarë të Republikës së Shqipërisë dhe asgjë tjetër. Periudha prej 14 vjetësh pluralizëm na ka mësuar se është shumë lehtë të jesh socialist, demokrat, socialdemokrat, komunist, legalist etj. «iste». Por shumë vështirë të jesh njeri. Dhe kjo do të thotë se Shqipëria nuk është e barabartë me qeverinë e Shqipërisë. Dhe kjo do të thotë se «Tërmetet Politike» të periferisë ku bën pjesë Shqipëria mund t'i tronditin shumë rëndë «Grataçielet Politike» të metropoleve në Bruksel, Romë, Berlin apo Paris. Dhe në fund për të mos harruar..Nxijeni akoma se nuk e kini nxirë mirë!!
21 /05/2004

«Delet e zeza» nisen për Lucernë !!

Tablloja e realitetit

Ose janë nisir ose do te nisen për në Lucernë elita e politikës shqiptare në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi dhe Lugina e Preshevës. Nano, Berisha, Meta, Rugova, Rexhepi, Thaçi, Ahmeti, Xhaferri, Haradinaj, Dinosha etj etj. Janë të ftuar nga Projekti I marrdhënieve Etnike. Tema është «Shqiptarët dhe fqinjët e tyre» !!

Hyrje në Analizë

Në muajin Prill 2000, i njëjti Projekt i Marrdhënieve Etnike organizoi në Budapest një takim me temën «Shqiptarët dhe fqinjët e tyre». Edhe atëhere pati një «batalion» politikanësh shqiptarë. Por edhe në muajin dhjetor 2000, por këtë herë në Athinë, i njëjti Projekt dhe e njëjta temë si dhe të njëjtit politikanë shqiptarë. Dhe kështu çdo vit elita e politikës shqiptare që nga Presheva në Konispol shkon ku ta thërrase një Projekt dhe flet për të njëjtën temë.

Analizë

Eshtë ndoshta takimi më i saktë për të parë poshtërimin demokratik të politikanëve

shqiptarë të Tiranës, Prishtinës, Tetovës, Ulqinit apo Preshevës. Një burrë «babaxhan» i quajtur Alen Kasof i mbledh të paktën brënda pesë vjetëve pesë herë për të njëjtin problem. Dhe i mbledh si thelb i problemit dhe jo si zgjidhje e tij. Një lloj gjyqi demokratik. Dhe elita jonë politike shkon. Por nuk e quan gjyq demokratik, por kontribute demokratike. Megjithatë një analizë jo e plotë, përsëri na çon në disa konkluzione të nevojshme për publikun

Shqiptarët në marrëdhënie ndërkombëtare nuk janë vetëm objekt i saj por edhe subjekt.

Bile në rajon janë subjekt ndër më kryesoret.

Në mënyrë të çuditshme ata trajtohen vetëm si objekt. Vetë titulli i takimit «Shqiptarët dhe fqinjët» është domethënës, ashtu siç është dhe cinik. Në rajonin e Ballkanit nuk jetojnë vetëm shqiptarët, por edhe sërbët, edhe grekët etj. Përse nuk është organizuar ndonjë takim me temë «Grekët dhe fqinjët e tyre», meqë Greqia është dhe antare e BE dhe mund të japë më shumë përvojë se si ndërtohen marrëdhëniet midis fqinjëve veçanërisht në fushën e minoriteteve dhe demokracisë ndaj tyre. Bile Greqia mund të japë përvojë se si eliminohen minoritetet në mënyrë demokratike!! Ose përse nuk organizohet një takim me temë «Sërbët dhe fqinjët e tyre» për më tepër që aktualisht në Sërbë proceset demokratike dhe ato të fqinjësisë janë më të rrezikuara. Për shëmbull një temë interesante mund të ishte : Si spiegethet që një muaj pas paralajmërimeve të shefit të shërbimit sekret të ushtrisë sërbe, në Kosovë ndodhin trazira ? Ose si spiegethet që dy muaj pas formimit të qeverisë së re sërbe, kërcënohet me vdekje familja e Zoran Gjingjiç ? Por jo.....tema është Standarte. Ajo tashmë dihet «Shqiptarët dhe fqinjët e tyre». Shqiptarët : Satanai i Ballkanit !! Domethënë: Shqiptarët i kanë përgjegjësitë për rajonin e trazuar të Ballkanit. Domethënë: Shqiptarët i kanë përgjegjësitë për Srebrenicën, për Kninin, për Vukovarin, për Sllavoninë, për Vreshatat e Reshtakut, për Lubotenin, për Gazi Mestanin, për fitoren e forcave radikale në Sërbë. Domethënë: Shqiptarët nuk dinë të sillen me fqinjët. Prandaj ti mesojmë një çikë, se si të sillen. Papërgjegjësi e politikës shqiptare dhe asgjë tjetër. Në një kohë që është e kundërta : Shqiptarët nuk dinë të sillen me njëri tjetrin ndërsa me

fqinjët sillen aq mirë sa e teprojnë. Përballë kësaj papërgjegjshmërie të politikës së lartë shqiptare, ndonjë ditë ka të ngjarë të diskutohet edhe libri ultrashovinist i ish-kryeministrit serb te viteve 30-te, Vladan Gjorgjeviçit.

Shqiptarët nuk janë «delja e zezë» e Ballkanit.

Ky pohim nuk është nacionalizëm, por realitet dhe dinjitet. Atëhere kur është kështu përse elita politike e shqiptarëve pranon të konsiderohet dele e zezë dhe merr rrugën sa herë e thërret Kasoffi. Për ilustrim në takimin e fundit në Lucernë nga pala shqiptare merrnin pjesë Fatos Nano, Ibrahim Rugova, Bajram Rexhepi, Sali Berisha, Ali Ahmeti, Arbër Xhaferri, Hashim

Thaçi, Ramush Haradinaj, Ferhat Dinosha etj të nivelit më të ulët. Jam i sigurt se i njëjti format do jete edhe tani. Ndërsa nga fqinjët në Lucernën numur një ishte një këshilltar i ministrit të jashtëm grek, Aleks Rondos, një nga ish shtate zëvendeskryeministrat serbë Nebojsa Coviç, Radmilla Sheqerinska, Gjorgje Spasov nga Maqedonia, por jo Cervenkovski, as Koshtunica e as Maroviçi e as Zoran Zhivkoviçi. Pa folur për disa specialistë apo gjoja njohës të Ballkanit të cilët debatojnë dhe kalojnë kohën me elitën e politikës shqiptare të cilët sa kthehen propagandojnë saktësinë e tyre dhe elokuencën e fjalimeve apo ndërhyrjeve të bëra. Por harrojnë një gjë. .Ato janë fjalime apo diskutime të «deleve te zeza».

Shqiptarët nuk janë delja e zezë e Ballkanit dhe ata nuk pranojnë te jene te tille. Ata duan te integrohen ne Ballkan si pjese kryesore e zgjidhjes së problemeve rajonale. Por jo si pjesa kryesore e problemeve të cilat në shumicën e rasteve ata i kane provuar në kurrizin e tyre në forme shovinizmi, racizmi dhe ksenofobie. Jo nga brënda, por nga jashtë, nga fqinjët e tyre.

Në Lucernë bën ftohtë !!

Edhe herën e parë Kasoffi mblodhi elitën e politikës shqiptare në Lucernë. Por atëhere ishte pragdimri dhe në Lucernë bënte ftohtë, shumë ftohtë.

Natyrisht ftohtësi politike. Por edhe këtë radhë në Lucernë bën ftohtë. Elita politike shqiptare shkon ne Lucernë kur mbi shqiptarët janë hedhur

disa akuza. E megjithatë elita politike e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë etj do te shkojë. Natyrisht dhe do flasë. Pastaj do kthehet. Ku ishe? Hiçgjëkundi. Cfarë bëtë? Muhabet. Ndërsa ftohtësia politike do te vazhdojë.

Shqiptarët do vazhdojnë të satanizohen. Atyre do tu keshillohet të tërhiqen akoma. Deri ku? Cili është kufiri pas të cilit është gremina? Këtë nuk e di

as Lucerna, as Athina, as Budapesti, as Kasoffi etj. Këtë duhet ta dinë vetë shqiptarët.

Millo Gjukanoviç duhet të kërkojë falje!!

Titulli i sipërthënë është edhe kërkesë për kryeministrin e Malit të Zi, Millo Gjukanoviç. Është edhe sugjerim për predikuesin e integriteteve europiane të Malit të Zi, Gjukanoviç. Por është edhe konstatim i një realiteti të përthyer që ndodhi një ditë para zgjedhjeve në rrethinat e komunës së Tuzit, e cila quhet shkurt Malësi.

Por çfarë ndodhi? U arrestuan me dhjetra shqiptarë nga policia speciale malazeze me akuzën përterrorizëm!!!. U tha nga zyrtarët e policisë malazeze dhe mediat e saj se në këto arrestime kishte ndihmuar edhe policia shqiptare. U tha nga mediat malazeze se shume shpejt do të ketë edhe arrestime të tjera në Shqipëri dhe Kosovë. Por disa ditë më pas reagoi Ministria e Brëndëshme e Shqipërisë duke thënë se: «Shqipëria ka ndjekur me vëmendje zhvillimin e zgjedhjeve të fundit parlamentare në Malin e Zi dhe ka mbështetur e mbështet të gjitha proceset demokratike në këtë vend fqinj. Vlerësojmë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimin e frytshëm në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë, duke përfshirë edhe atë të sigurisë dhe bashkëpunimit policor, me bindjen se stabiliteti i Malit të Zi i shërben sigurisë në të gjithë rajonin. Ministria e Brëndëshme, duke marrë shkas nga njoftimi i agjensisë së lajmeve MINA se operacioni i ditëve të fundit për arrestimin e rreth 14 qytetarve me origjinë shqiptare, shtetas malazez, është bërë në bashkëpunim me autoritetet policore të Shqipërisë, bën të ditur se forcat policore të Shqipërisë nuk kanë marrë pjesë në asnjë lloj bashkëpunimi policor me forcat policore të Malit të Zi, gjatë këtyre ditëve. Një lajm i tillë është tërësisht i pavërtetë. Ne shpresojmë se autoritetet e Malit të Zi do të qartësojnë pavërtetësinë e lajmit dhe motivet e tij.»

(Deklarate për shtyp e MPB të Shqipërisë datë) Por asgjë nuk ka ndodhur deri sapo shkruajmë këto rreshta. Policia dhe drejtuesi faktik i saj Millo Gjukanoviç, nuk kanë qartësuar motivet e këtij lajmi, ashtu siç nuk kanë qartësuar motivet reale të arrestimeve. Përkundrazi kanë shtuar torturat e të arrestuarve. Por dikush mund të thotë se Millo nuk ka përgjegjësi sepse mund të ketë qënë ndonjë politikan shqiptar që ka kërkuar ndihmën e policisë etj etj. Edhe kështu mund të ketë qënë në dukje. Por asesi politikani shqiptar dhe «kërkesa» e tij nuk justifikon veprimin e policisë speciale të Malit të Zi. Përsëri dikush mund të thotë se në shtëpitë e të arrestuarve u gjetën armë me shumicë dhe flamuj shqiptarë me shumicë. Bukur. Janë dy probleme që kërkojnë analizë të ftohtë. I pari ka të bëjë me armët e gjetura në shtëpitë e shqiptarëve të arrestuar.

Gjukanoviç e di më mirë se sa policia e tij speciale origjinën e këtyre armeve. Sepse ka gene ai që ua ka shpërndarë shqiptarëve kur i rrezikojë koka nga Milosheviçi dhe ushtria e tij që ishte dislokuar në Mal të Zi. (Origjinën e këtyre armëve e dinë edhe dy -tre politikanë të lartë shqiptarë që tani heshtin për hir të karrierës së tyre politike). Prandaj alibia me armë është një skup mediatik që zgjati vetëm një orë. I dyti ka të bëjë me flamurin shqiptar. Në këtë rast policia malazeze ka pasur të drejtë. Në Mal të Zi shqiptarët me Kushtetutë e kanë të ndaluar të përdorin flamurin e tyre kombëtar. (Njesoj si në kohën e ish-Jugosllavisë). Prandaj në këtë rast policia ka zbatuar ligjin !! (A e kanë

ditur dhe a e dinë këtë gjë politikanët shqiptarë të Tiranës apo të Kosovës që nuk mungojnë të thurin lavde për Millon apo të bëjnë biznes të pastër dhe të papastër me atë duke arritur deri atje sa të harrojnë se në çfarë mënyre Ulqini dhe Plavë Guçia ju aneksuan Malit të Zi) Nuk mund ta dinë. Kazinot e Budvës dhe të Shën-Stefanit nuk janë pjesë e historisë dhe realitetit shqiptar, por pjesë e kënaqësisë personale e cila është pa komb e kombësi. E megjithatë, shqiptarëve me kushtetutë në Mal të Zi nuk u lejohej të përdorin simbolet kombëtare. Millo këtë e di, politikanët shqiptarë akoma nuk e dinë. Prandaj nuk reagoi askush prej tyre me përjashtim të Ministrisë së Brëndëshme. Siç duket bizneset e nisura qyshkur me Millon janë më të rëndësishme se një flamur apo 14 arrestime. Millo duhet të kërkojë falje tek shqiptarët edhe për një provokacion tjetër. Policia, media dhe propaganda e tij u përpoq që të mbillte farën e përçarjes fetare në zonën e Malësisë e cila përbëhet nga shqiptarë të fesë muslimane dhe asaj katolike. Por dështoi. (Kur policia malazeze i theu në kokë një plaku fotografinë e Adem Jasharit, ai ju përgjigj : Mosni bre, mos më fyeni Krishtin tim. Dhe plaku ishte i fesë katolike. Por Jezu Krisht kishte Adem

Jasharin), Dhe për ta mbyllur përkohësisht këtë temë të saponisur, duhet ti japim përgjegje edhe një pyetjeje që mund të bëhet : Por tani Millo dhe grupi i tij e fituan pavarësinë dhe nuk kanë nevojë për popullin shqiptar në Mal të Zi. Ata kanë nevojë për disa kryetarë partish shqiptare, të cilët i kanë me vehte. Kjo është e vërtetë. Por është një e vërtetë dritëshkurtër. Sepse deri më sot, problemet e Malit të Zi mbulohehin nga Serbia dhe problemet e saj. Tashmë Mal i Zi do të ndeshet me problemet e tij. Por ato nuk mund të mbulohen më nga Serbia. Prandaj Millo Gjukanoviç duhet tu kërkojë falje shqiptarëve për fyryrjen që u ka bërë. Është një kërkesë demokratike, një sugjerim fqinjësor, por edhe një konstatim pabesie nga ana e tij. Ashtu siç është edhe një prognozë për të ardhmen. (Millo e di nga stafi i tij se Konferenca e Versajës i hoqi Malit të Zi pavarësinë para një shekulli. Kjo padrejtësi u rivendos para dy muajsh, kur u rifitua pavarësia). Por anulimi i Konferencës Artificiale të Versajës, do të vlejë edhe për shqiptarët të cilët do të kenë të drejtën demokratike për të kërkuar me Referendum Shqiptarinë Natyrale.